



ProCredit Bank

Kosovo

Raporti Vjetor 2015

Përmbajtja

Misioni i bankës	3
Etika e biznesit dhe standardet mjedisore.....	5
Informatat themelore për bankën	7
Segmentet e Biznesit	8
Kanalet Elektronike të Bankimit.....	10
Menaxhimi i rrezikut	12
Punëtorët dhe zhvillimi i tyre.....	15
Hapat tonë drejtë një mjedisi më të pastër.....	19
Perspektiva e bankës për vitin 2016.....	20
Pasqyrat financiare.....	22

Misioni i Bankës

Banka ProCredit është bankë komerciale e orientuar drejt zhvillimit. Ne ofrojmë shërbime cilësore për bizneset e vogla dhe të mesme si dhe për klientët privatë që dëshirojnë të kursejnë. Në operacionet tona ne i përmbahemi një numri të caktuar parimesh bazë: ne vlerësojmë transparencën gjatë komunikimit me klientët tanë, nuk promovojmë kredi konsumuese, jemi të përkushtuar në uljen e ndotjes mjedisore si dhe ofrojmë shërbime të cilat janë të bazuara në gjendjen e çdo klienti si dhe në analizën e shëndoshë financiare.

Fokusi ynë është ofrimi i shërbimeve për ndërmarrjet të vogla dhe të mesme, sepse jemi të bindur që këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe u japin një kontribut thelbësor ekonomive në të cilat operojnë. Duke ofruar shërbime të thjeshta depozituese për klientët privatë si dhe duke investuar burime të konsiderueshme në edukimin financiar, ne kemi për qëllim ta promovojmë kulturën e kursimit, e cila mund të sjellë qëndrueshmëri dhe siguri për familjet.

Aksionarët tanë presin një fitim të qëndrueshëm nga investimi në afat të gjatë, dhe nuk janë të interesuar për maksimizimin e fitimit në afat të shkurtër. Ne bëjmë investime të mëdha në trajnimin e stafit në mënyrë që të krijojmë atmosferë të kënaqshme dhe efikase të punës, si dhe të ofrojmë shërbime profesionale dhe të përshtatshme për klientët tanë.





Etika e biznesit dhe standardet mjedisore

Pjesë e misionit të përgjithshëm të grupit ProCredit është përcaktimi i standardeve në sektorët financiar në të cilët ne operojmë. Ne duam që të bëjmë ndryshim – përmes grupeve të synuara të cilëve u shërbejmë, përmes cilësisë së shërbimeve tona financiare dhe përmes etikës afariste. Operacionet e institucioneve ProCredit udhëhiqen nga këto parime:

Transparenca: Ne ofrojmë informata transparente për klientët tanë, për opinionin publik dhe për punonjësit tanë.

Për shembull, ne sigurohemi që klientët të kuptojnë plotësisht kushtet e kontratave të cilat ata i lidhin me ne dhe angazhohemi në edukimin financiar me qëllim që të ngrisim vetëdijen e publikut për rreziqet e ofertave financiare jo transparente.

Kultura e komunikimit të hapur: Ne komunikojmë me njëri tjetrin haptas, në mënyrë të drejtë dhe konstruktive. Ne i trajtojmë konfliktet në punë në mënyrë profesionale, duke punuar bashkarisht për të gjetur zgjidhje.

Përgjegjësia dhe toleranca shoqërore: Ne ofrojmë këshilla të shëndosha dhe me bazë të sigurtë për klientët tanë. Para se të ofrojmë kredi për klientët tanë, ne vlerësojmë gjendjen e tyre ekonomike dhe financiare, potencialin e tyre të biznesit dhe kapacitetin e tyre për kthimin e kredisë në mënyrë që të shmanget mbi borxhi dhe që të ofrojmë shërbime të përshtatshme financiare. Për më tepër, ne jemi të përkushtuar në trajtimin e të gjithë klientëve dhe punëtorëve me korrektësi dhe respekt, pa marrë parasysh origjinën, racën, gjuhën, gjininë apo besimet e tyre fetare.

Ne gjithashtu sigurohemi se kërkesat e aplikuesve për financim vlerësohen në aspektin e përputhshmërisë me praktikën tonë etike afariste. Asnjë kredi nuk është lëshuar për individë ose biznese, në qoftë se dyshohet se ata janë duke përdorur metoda të punës të cilat janë të pasigurta, të dëmshme për ambientin apo moralisht të papranueshme, veçanërisht shfrytëzimi i fëmijëve për punë.

Standarde të larta profesionale: Punëtorët tanë marrin personalisht përgjegjësi për kualitetin e punës së tyre dhe gjithmonë përpiqen për t'u ngritur profesionalisht.

Integritet dhe përkushtim personal: Sinqeriteti i plotë kërkohet në çdo kohë nga të gjithë punëtorët e grupit ProCredit, dhe çdo mosrespektim i këtij parimi trajtohet shpejt dhe në mënyrë rigoroze



Bordi Menaxhues
nga majtas:

Ilir I. Aliu
Drejtor Gjeneral

Eriola Bibolli
Zëvendës Drejtoreshë Gjenerale

Informatat Themelore të bankës ProCredit

Aksionari	Shuma e vlerës nominale (EUR)	Numri i aksioneve	në %
ProCredit Holding	61,346,210	12,269,242	100
Totali	61,346,210	12,269,242	100

ProCredit Holding është kompania prind e një grupi global bankash ProCredit e cila operon në Evropën Lindore, Amerikën Latine si dhe në Gjermani. ProCredit Holding është themeluar si Internationale Micro Investitionen AG (IMI) në vitin 1998 nga kompania pioniere konsulente për zhvillimin financiar IPC.

ProCredit Holding është e përkushtuar në zgjerimin e qasjes në ofrimin e shërbimeve financiare në vendet në zhvillim dhe ekonomitë në tranzicion duke ndërtuar një grup bankash që janë udhëheqëse të ofrimit të shërbimeve financiare të drejta, dhe transparente për bizneset shumë të vogla, të vogla dhe të mesme si dhe për popullatën në vendet në të cilat operojnë. Përveç përmeshjes së nevojave të kapitalit të vartësve të saj, ProCredit Holding udhëheq zhvillimin e bankave ProCredit, kujdeset për sigurimin e menaxhmentit të lartë, si dhe mbështet bankat në të gjitha fushat e aktivitetit, duke përfshirë operacionet bankare, burimet njerëzore dhe menaxhimin e riskut. Ajo kujdeset që vlerat e korporatës ProCredit, praktikat më të mira ndërkombëtare si dhe principet e Baselit II të menaxhimit të riskut të implementohen në gjithë grupin bashkë me standardet, gjithashtu të vendosura nga autoritetet gjermane të mbikëqyrjes.

IPC-ja është aksionari udhëheqës si dhe investitori strategjik në ProCredit Holding. IPC-ja ka qenë forca shtytëse ndërmarrëse prapa grupit ProCredit që nga themelimi i bankave.

ProCredit Holding është partneritet publiko privat. Përveç IPC-së dhe IPC Invest (makina investuese e stafit të IPC dhe ProCredit), aksionarët e tjerë privatë të ProCredit Holding përfshijnë fondacionin Dutch DOEN, fondin pensional amerikan TIAA-CREF, fondin amerikan të mikrofinancave Omidyar-Tufts dhe fondin investues zviceran responsibility. Aksionarët publikë të ProCredit Holding përfshijnë KfW (bankën promocionale gjermane), IFC (sektori privat i Bankës Botërore), FMO (banka zhvillimore holandeze), BIO (Kompania Investuese Belge për Vendet në Zhvillim) dhe Proparco (Kom-

pania investuese dhe Promovuese Franceze për Bashkëpunim Ekonomik).

Forma ligjore e ProCredit Holding është e ashtëquajtura KGaA (Kommanditgesellschaft auf Aktien, ose në shqip një partneritet me përgjegjësi të kufizuar). Kjo është një formë ligjore e përdorur shpesh në Gjermani, e cila në thelb mund të konsiderohet si një kompani aksionare në të cilën roli i bordit drejtues është marrë përsipër nga një partner i përgjithshëm, dhe në të cilën partneri i përgjithshëm ka të drejtat e pëlqimit mbi vendime të caktuara të aksionarëve. Në rastin e ProCredit Holding, partneri përgjithshëm është një kompani e vogël e veçantë e cila zotërohet nga aksionarët kryesorë të ProCredit Holding AG&CO, KGaA, IPC, IPC Invest, DOEN, KfW dhe IFC. Struktura KGaA do t'i lejojë ProCredit Holding të rrisë kapitalin në të ardhmen pa ulur ndikimin e aksionarëve kryesorë në sigurimin e gjithë qëllimeve, në zhvillimin dhe suksesin tregtar.

Segmentet Kyçe të Biznesit



Klientët e Biznesit

Në përputhshmëri të plotë me vizionin e saj, Banka ProCredit me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë është angazhuar në ofrimin e shërbimeve cilësore bankare për klientët e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Në linjë me strategjinë e bankës edhe gjatë vitit 2015 fokus ishte zhvillimi i mar-rëdhënieve të mira dhe afatgjata me klientët e biznesit. Prandaj, përveç ofrimit të shërbimeve të kreditimit, ne kemi vënë një theks të veçantë në promovimin e shërbimeve tjera bankare dhe në shërbimet ele-ktronike, të cilat i vlerësojmë si të dobishme për klientët tanë. Për t'i plotësuar nevojat bankare të klientëve të biznesit ne kemi sjell inovacion në mënyrën e bankimit duke i implementuar "ZONAT 24/7" për një bankim të shpejtë dhe të sigurt. E veçanta e këtyre zonave është se në to janë të vendosura pajisje

të tilla të teknologjisë së lartë të cilat i ofrojnë fleksibilitet dhe efikasitet të lartë klientëve të biznesit pa pasur nevojë të kufizohemi nga orari i punës së bankës. Ndër shërbimet bankare të cilat ofrohen në "ZONAT 24/7" janë: Bankomatët deponim/tërheqje, kasafortë për deponim, makinë për pagesa, këndi i transferteve, këndi e-Banking, këndi informues dhe qendra e thirrjeve.

Për më tepër si rezultat i ndërtimit të relacioneve afatgjata me klientët e biznesit dhe zhvillimit të infrastrukturës bankare, mbi 75% e deponimeve me para të gatshme në dhjetor 2015 kaluan përmes kanaleve të automatizuara. Kjo ju mundësoi Këshilltarëve të Klientëve që të ofrojnë shërbime dhe këshilla më cilësore klientëve tanë të biznesit. Si rrjedhojë edhe depozitat e klientëve të biznesit gjatë vitit 2015 shënuan rritje mbi 18%.

Edhe gjatë këtij viti u vazhdua me trajnime të Këshilltarëve të klientëve për biznese të cilët kanë rol kyç në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët e biznesit. Këshilltarët e klientëve të biznesit edhe më tutje janë të dedikuar në këshillim të bizneseve me qëllim të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve adekuate për biznese, bazuar në nevojat përkatëse të secilit biznes.

Me qëllim të promovimit të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik edhe gjatë këtij viti fokus i veçantë ju dha promovimit dhe stimulimit të kredive investive e posaçërisht kompanive prodhuese. Gjatë vitit 2015 mbi 35% e total kredive të disbursuara ishin të destinuara si kredi investive. Kontribut të veçantë për arritje të këtij objekti ishte përkrahja nga Banka Evropiane për Investim(EIB) dhe Fondi Evropian për Investime(EIF) me dy fonde kreditore me qëllim të stimulimit të investimeve për klientët tanë të biznesit.

Gjatë vitit 2015 në total Banka disbur-soi 683 kredi të reja biznesi dhe rritja në portfolion e biznesit gjatë vitit 2015 ishte 24.8 Milion ku volumi total i kredive dedikuar bizneseve në fund të vitit 2015 arriti në 328.7 milionë euro.

Bizneset e prodhuesve vendor bujqësorë dhe të përpunuesve të ushqimeve janë një grup shumë i rëndësishëm për Bankën ProCredit, ku si bankë duke u inkuorporuar brenda këtij zinxhiri bashkëpunues for-mojnë një partneritet të domoshëm për zhvillimin afatgjatë e të qëndrueshëm të sektorit bujqësor në përgjithësi. Në këtë segment gjatë vitit 2015 fokusi kryesisht ka qenë tek investimet kapitale bujqësore afatgjate si: zgjerimin e kapacitetit të fermave, ndërtimin e depove për ruajtjen e produkteve vendore, mod-ernizimin e mekanizmit bujqësorë (përmes partnerëve tanë të agrobiznesit), ngritjen e serrave të reja, blerjen e tokës bujqësore etj. Si rezultat i zhvendosjes së fokusit në ekspozimet kreditore \Rightarrow 10,000 euro, me fokus të veçantë te klientët portfolio totale e agro kredive ka shënuar rritje për 5.3 milion në 44 milion, me ekspozime kreditore mbi 10 mijë euro kemi rritje prej 12.4 milionë euro.

ProCredit si bankë e cila kryen veprimtari të përgjegjshme bankare ka fokus të veçantë të vepruarit në pajtueshmëri me standardet mjedisore. Banka ka vazhduar me mbështetjen e klientëve të saj të cilët kanë investuar përmes Kredive të Gjël-

bra, term ky që i karakterizon të gjitha shërbimet financiare për investim në kursim të energjisë, në burime të energjisë së ripërtitshme, si dhe masa tjera ekologjikisht miqësore.

Vitet paraprake investime të tilla janë ndërmarrë më shumë nga klientët privatë, që kanë investuar kryesisht në izolimin e shtëpive të tyre. Kurse gjatë vitit 2015 qëllimi ka qenë që sa më shumë të stimulohen klientët e bizneseve që të ndërmarrin investime të tilla, me fokus të veçantë në avancim të makinerive prodhuese dhe në masa që do të ulnin ndotjen e ujit apo të ajrit. Si rrjedhojë pjesëmarrja e kredive të gjelbra në portfolion e përgjithshme të klientëve të biznesit, në fund të vitit 2015, arriti në kuoten prej rreth 5%, apo 16 milion Euro.

Banka do të vazhdojë që të përshtatë shërbimet bankare në funksion të bizneseve me qëllim që të krijohen masa lehtësuese gjatë afarizmit të tyre. Përveç përkrahjes së investimeve afatshkurtra dhe afatmesme të bizneseve, fokusi ynë i veçantë për vitin 2016 do të vazhdojë të jetë në përkrahjen dhe stimulimin e investime afatgjata, e në veçanti në përkrahjen e bizneseve prodhuese.



Klientët Privatë

Institucioni ynë bankar ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të dizajnuar shërbime bankare të cilat ndihmojnë klientët tanë për t'i menaxhuar më lehtë financat e tyre. E orientuar në ofrimin e këshillave profesionale, edukimin financiar dhe kredidhënie të përgjegjshme, Banka ProCredit ka vazhduar mbështetjen e fuqishme në realizimin e projekteve investive të klientëve të saj privatë, projekte këto të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë i kontribuojnë ngritjes së cilësisë së jetesës të klientëve tanë. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2015 Banka ProCredit fokus të veçantë kishte financimin e klientëve të cilët investuan në blerjen e patundshmërive, me ç' rast portofoli i kredive hipotekare shënoj rritje prej 27% në raport me vitin paraprak. Qasja e përgjegjshme në mbrojtjen mjedisore është pjesë e rëndësishme e përgjegjësisë shoqërore të Bankës ProCredit dhe

vlerë e integruar në filozofinë tonë bankare. Në këtë kontekst, Banka ProCredit edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me mbështetjen e pa lëkundur të klientëve të saj të cilët kanë investuar në rritjen e masave që i kontribuojnë mbrojtjes së mjedisit dhe kursimit të energjisë. Portofoli i kredive të gjelbra gjatë vitit 2015 shënoj rritje prej 17% krahasuar me vitin 2014. Kreditë ose financat e gjelbra nënkuptojnë të gjitha aktivitetet financiare për investim në kursim të energjisë, investim në burime të energjisë së ripërtëritshme, dhe investime të tjera ekologjikisht miqësore.

Ndonëse viti 2015 u karakterizua nga një konkurrencë e fortë në fushën e kreditimit të klientëve privatë, Banka ProCredit arriti që cilësinë e portfolios kreditore të klientëve privatë, të përbërë nga kreditë hipotekare, kreditë e gjelbra, kreditë për renovim, kreditë për shkollim, kreditë private,

mbitërheqjet dhe kartelat e kreditit, ta mbajë në nivel mjaftë të mirë.

Banka ProCredit dëshmoi edhe këtë vit besueshmërinë e fituar nga klientët e saj bazuar në qëndrueshmërinë e depozitave, në veçanti qëndrueshmërinë e depozitave në llogarinë e kursimit. Depozitat e klientëve privatë ende vazhdojnë të përfaqësojnë shumicën e depozitave të bankës, që kapin 72.7% të vlerës totale prej 672 milion në fund të vitit 2015. Përbërja e portofolit të depozitave për vitin 2015 sipas llogarisë rrjedhëse, llogarive të kursimit dhe depozitave me afat ishte 44%, 38% përkatësisht 18% të totalit. Në anën tjetër sa i përket klientëve privatë, banka ka vazhduar rregullisht të theksojë rolin e kursimeve pasi ato janë një faktor i rëndësishëm për të ju ofruar klientëve tanë stabilitet financiar.

Kanalet elektronike të bankimit

Për t'i plotësuar nevojat bankare të klientëve tanë ne kemi sjell inovacion në mënyrën e bankimit duke i avancuar "ZONAT 24/7" për një bankim të shpejtë dhe të sigurtë.

Vendosja e Zonave 24/7 në të gjitha qytet dhe qytezat e mëdha të Kosovës i ka mundësuar bankës që të promovojë një koncept unik të shërbimeve bankare në nivel kombëtar, dhe tashmë rezultatet mund të shihen nga ndryshimi i trendeve në përdorimin e kanaleve bankare.

Me shtimin e bankomateve për deponim, ka ndodhur një ndryshim i madh veçanërisht në transaksionet e deponimeve. Numri i deponimeve në bankomate është rritur nga viti në vit, ndërsa rritja në vëllim është edhe më e lartë. Bankomatet janë përdorur gjithnjë e më shumë për deponime nga ana e bizneseve, të mundësuar edhe nga produkti i kartelës së veçantë i cili iu mundëson te agjentëve të bizneseve të bëjnë deponime në mënyrë të pavarur, si dhe nga shtimi i funksioneve shtesë në makina. Për t'i plotësuar nevojat e klientëve të bizneseve të mesme, kasafortat për deponime (DropBox) janë vendosur në më shumë Zona 24/7 në mënyrë që mundësohen deponime më të mëdha.

Tërheqjet e parave në bankomate, një fushë në të cilën ne tashmë qëndronim mirë, po ashtu kanë

shënuar rritje. Vëllimi i përgjithshëm i tërheqjeve është rritur dukshëm, i ndihmuar edhe nga limiti i paracaktuar, fillimisht nga 500€ në 1,000€ dhe pastaj në 2,000€. Këto ndryshime, si dhe shtimi i më shumë makinave në zona, pajisja e klientëve me kartela dhe puna e vazhdueshme me klientë, që të gjitha kanë pasur ndikimin e tyre. Gjatë vitit janë testuar edhe procedurat që mundësojnë tërheqje deri në 10,000€ në Zonat 24/7; tani ato janë të gatshme për zbatim më të gjerë gjatë vitit 2016. Shërbimi e-banking ka vazhduar rritjen në përqindjen e përgjithshme të transferteve bankare, dhe janë bërë përditësime të rëndësishme të cilat do ta bëjnë atë të dobishëm për një gamë më të gjerë të klientëve. Zhvillimi i një versioni të kufizuar të e-pasqyrës e cila mund të përdoret për të kontrolluar pasqyrat e llogarisë pa token ka pasur për qëllim që të zvogëlojë veçanërisht numrin e vizitave në degët e bankës për nevoja të thjeshta bankare.

Menaxhimi i Rrezikut

Menaxhimi i rrezikut të kredive

Biznesi kryesor i Bankës ProCredit përbëhet nga huadhënia për klientët e bizneseve të vogla dhe të mesme si dhe klientëve privatë që dëshirojnë të kursejnë. Kështu, rreziku klasik kreditor (d.m.th rreziku që huamarrësit nuk do të jenë në gjendje ti përmbushin detyrimet e tyre me kontratë ndaj bankës ose do të jenë në gjendje ti përmbushin ato vet pjesërisht) është rreziku më i rëndësishëm me të cilin përballet banka. Prandaj, rreziku kreditor përbën pjesën më të madhe të rrezikut në kontekstin e llogaritjes së kapacitetit të bartjes së rrezikut.

Parimet themelore të bankës për menaxhimin e rrezikut kreditor janë të vendosura në politikën e bankës për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe vlerësimin e kolateralit. Këto politika janë në bazë të politikës së menaxhimit të rrezikut kreditor dhe politikën e vlerësimit të kolateralit të grupit ProCredit, të cilat së bashku pasqyrojnë përvojën e grupit, të fituara gjatë aktiviteteve të suksesshme të huadhënies në ekonomitë në zhvillim dhe tranzicion. Këto politika janë në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës.

Banka zbaton parime të caktuara për ta menaxhuar dhe ulur rrezikun kreditor. Këto parime përfshijnë analiza intensive të kapacitetit për borxhe të klientëve, shmangie e mbingarkimit të klientëve, monitorimin e ekspozimeve kreditore problematike, zbatimin e proceseve të dizajnuara me kujdes dhe dokumentuara, zbatimin e parimit “në katër sy”, ndërtimin e një marrëdhënie personale më afatgjate me klientin duke mbajtur kontakte të rregullta, si dhe investimi në punëtorë të trajnuar mirë dhe të motivuar.

Për më tepër, diversifikimi i portfolios së kredive është një pjesë përbërëse e politikës së menaxhimit të rrezikut kreditor. Ky diversifikim është në të gjithë sektorët e ekonomisë, grupet e klientëve, bizneset e vogla dhe të mesme si dhe individët privatë dhe institucionet.

Një karakteristikë tjetër e qasjes së bankës është se ajo kërkon t’u japë klientëve produkte të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme. Edhe shkalla e lartë e diversifikimit, produktet dhe procedurat e thjeshta dhe transparente ulin profilin e përgjithshëm të rrezikut të bankës.

Metoda të ndryshme të menaxhimit të rrezikut kreditor zbatohen kur banka ka të bëjë me kategori të ndryshme të klientëve dhe ekspozimeve kreditore. Karakteristikat kryesore të proceseve të kreditimit për klientët e biznesit dhe privatë dhe për kategori të ndryshme të ekspozimeve kreditore janë: ndarja e detyrave për ekspozimet mesatare kreditore, proceset e standardizuara në huadhënie për klientët e bizneseve të vogla si dhe për klientët privatë, bazë e informatave për analizë kreditore për ekspozime të ndryshme kreditor, kriteret për vendimet e ekspozimeve kreditore dhe kërkesat e ndryshme të kolateralit në bazë të dokumentacionit, shumave dhe historisë kreditore të klientit.

Për më shumë, vlerësimi i kolateralit është kryer nga një kompani e jashtme e licencuar e cila zvogëlon rrezikun e vlerës së vlerësuar të kolateralit.

Pasi që pjesa më e madhe e kredive të bankës paguhet në këste mujore, nëse huamarrësi nuk arin të përmbushë një afat të pagesës, kjo trajtohet si një shenjë fillestare e mos pagesës së mundshme dhe kërkon përgjigje të menjëhershme nga banka.

Megjithatë për shumicën e vitit 2015, treguesi i rëndësishëm i cilësisë së portfolios së kredive si dhe për matjen e rrezikut të kredive ishte PAR₃₀, duke pasur parasysh vetëm kalimin e afatit të pagesës së interesit ose principalit për më shumë se 30 ditë.

Në vitin 2015, ka pas rënie PAR₃₀ i përgjithshëm i bankës. Rënia më e madhe e PAR ka pas në kategorinë e kredive të biznesit më të mëdha se EUR 250’000 (ekspozimet e bizneseve të mesme) dhe kreditë deri në 250’000 EUR (ekspozimet e bizneseve të vogla) pasi që ndikimi i vazhdueshëm i censueshmërisë së institucioneve financiare bankare në kredidhënie .Kjo ka shërbyer si një nxitje për rritjen e investimeve në sektorin e biznesit. Për më tepër, duhet të theksohet se duke u bazuar në raportet e publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, kreditë jo - performuese të Bankës ProCredit janë në nivel shumë më të mirë sesa mesatarja e sektorit bankarë të Kosovës në përgjithësi.

Banka ProCredit në Kosovë ka një qasje konservative ndaj rezervës së humbjeve nga kreditë. Rezervat për ekspozimet e rëndësishme individualisht me shenja të dëmtimit vendosen në bazë të

rezultateve të një vlerësimi individual të dëmtimit, ndërsa rezerva për kreditë e dëmtuara të cilat janë individualisht të rëndësishme, llogaritet në bazë të normave historike të mos pagesës. Për të gjitha ekspozimet e padëmtuara kreditore, bëhet rezerva të dëmtimit në bazë të portfolios. Në fund të vitit raporti i mbulimit (rezervat e humbjeve nga kreditë sipas BQK-së, si përqindje e PAR₃₀ ditë) ishin 121%, dhe raporti i mbulimit të kredive jo performuese ishte 118%. Kreditë që konsiderohen të jenë të pakthyeshme vazhdimisht shlyhen. Megjithatë, përpjekjet për kthim vazhdojnë edhe pasi kredia të jetë shlyer, dhe marrja e kolateralit zbatohet në mënyrë rigoroze.

Menaxhimi i rrezikut të ekspozimit ndaj palëve tjera

Me qëllim të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit si dhe për qëllime të tjera operationale, sikurse janë realizimi i transferteve, Banka ProCredit investon dhe mban një pjesë të likuiditetit të saj tek palët e tjera, përfshirë emetuesit e letrave me vlerë. Me këtë rast, banka i ekspozohet rrezikut të këtij ekspozimi, që nënkupton rrezikun që këto palë mund të mos jenë të gatshme apo të afta të përmbushin obligimet e tyre ndaj bankës.

Megjithatë, këto rreziqe menaxhohen nga banka në mënyrë aktive dhe të kujdesshme përmes politikave së saj të menaxhimit të rrezikut të palëve tjera, politikave të menaxhimit të likuiditetit, politikave të thesarit, politikave të investimeve, etj. Në këto politika, si dhe në procedura të tjera të bankës, definohen në detaje proceset e përzgjedhjes së kujdesshme të palëve tek të cilat banka ekspozohet, përcaktohen limitet e ekspozimit, transaksionet e lejuara në këto raste, kontrollet dhe monitorimet, si dhe rregullat e procesimit të tyre, etj.

Banka ProCredit ka një tolerancë relativisht të ulët ndaj këtij rreziku dhe nuk zhvillon aktivitete treguese spekulative. Palët e tjera të përzgjedhura, parimisht janë institucione me klasifikim të lartë kreditor, reputacion të mirë dhe me qëndrueshmëri të lartë financiare. Në parim, asnjë ekspozim ose marrëveshje nuk mundet të realizohet pa përcaktuar paraprakisht një limit. Procesi i vendosjes së limiteve bëhet duke u bazuar në analizë të thukët nga banka, të cilat rishikohen në baza vjetore. Për më tepër, politikat dhe procedurat e

bankës janë në përputhje me rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Edhe rreziku ndaj emetuesve të letrave me vlerë është i kontrolluar, impakti nga ndryshimet në çmimet e tregjeve është i limituar për bankën bazuar në maturitete përgjithësisht të shkurtra të letrave me vlerë dhe përzgjedhje të emetuesve bazuar në kriteret e matura të rrezikut.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit Rreziku i likuiditetit paraqet rrezikun që një bankë nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet aktuale dhe të ardhshme të saj në mënyrë të plotë ose në kohën e duhur. Rreziku i financimit është rreziku se financimi shtesë mund të merret vetëm me norma të interesit shumë të larta apo nuk mund të merret fare në rast nevojë.

Banka ProCredit menaxhon rrezikun e likuiditetit përmes politikave dhe procedurave të saj në përputhje me kërkesat e autoriteteve rregullative në vend. Kontrollimi dhe zvogëlimi i rrezikut të likuiditetit mbështetet nga modeli i biznesit të bankës. Nga njëra anë, portofolio e kredisë karakterizohet nga një numër i madh i ekspozimeve afatshkurtra dhe afatmesme për klientët. Shumica e këtyre kredive janë disbursuar si kredi me anuitetit dhe kanë cilësi të lartë. Nga këndvështrimi i rrezikut të likuiditetit, kjo çon në rrjedhat hyrëse të diversifikuara dhe të parashikueshme. Nga ana tjetër, depozitat e klientëve janë burimi ynë kryesor i financimit ndërsa përdorimi i instrumenteve të tregjeve financiare është i ulët.

Si pjesë e menaxhimit të likuiditetit, banka ka definuar dhe përcjellë vazhdimisht indikatorët e saj të likuiditetit. Gjithashtu, testet e stresit të likuiditetit zhvillohen rregullisht bazuar në skenarë të definuar që ndihmojnë bankën për të analizuar pozicionet e saj të likuiditetit në rast të tronditjeve potenciale të brendshme apo të jashtme. Gjatë vitit 2015, Banka ProCredit ka pasur një nivel shumë të kënaqshëm të likuiditetit. Në fund të vitit 2015, indikatorit i mjeteve shumë likuide ka qëndruar në 45%, që paraqet një situatë të kënaqshme të likuiditetit.

Banka e konsideron rrezikun e financimit të jetë i ulët për shkak të mbështetjes në larmishmërinë e depozitave të konsumatorëve, si dhe faktin që banka vazhdon të ketë qasje në financim nga burime të ndryshme ndërkombëtare.

Menaxhimi i rrezikut të valutës

Rreziku i valutës së huaj definohet si rreziku i efekteve negative në rezultatet financiare dhe mjaftueshmërisë së kapitalit të një institucioni të shkaktuara nga ndryshimet në kurset e këmbimit në treg. Rreziku i valutës së huaj menaxhohet nga Banka ProCredit në pajtim me politikën e menaxhimit të rrezikut të valutës së huaj, që respekton kërkesat e Rregullores së BQK-së.

Banka ProCredit ka një nivel të ulët të ekspozimit ndaj rrezikut të valutës sepse ajo nuk mban pozitat e hapura të valutës në mënyre spekulative. Vitin 2015 banka e ka mbyllur me një pozicion të hapur mesatarisht 0.21% në raport me kapitalin e klasit të parë sipas definicioneve të BQK-së.

Pozitat e valutës menaxhohen në baza ditore dhe normat e këmbimit të valutave të huaja monitorohen në mënyre të vazhdueshme. Banka ka përcaktuar limite të lejuara për këtë rrezik të cilat nuk janë tejkaluar asnjëherë gjatë vitit 2015. Andaj, rreziku i valutës së huaj konsiderohet të jetë i ulët. Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit. Rreziku i normës së interesit vjen nga ndryshimet strukturore midis maturiteteve të rivlerësimit të mjeteve dhe detyrimeve. Kjo mund ta ekspozojë bankën ndaj rrezikut që kostot e financimit mund të rriten, ndërkohë që kthimi nga asetet mund të mbetet i njëjtë për një kohë më të gjatë duke zvogëluar margjinën.

Edhe për këtë rrezik, banka ka në fuqi politikën përkatëse. Banka bën vazhdimisht analizat e hendekut të maturitetit (bazuar në ri-caktimin e çmimeve) në mes mjeteve dhe detyrimeve. Banka po ashtu aplikon stres teste përmes simulimit të lëvizjeve të normave të interesit për të matur ndikimin në vlerën ekonomike dhe në të ardhurat nga interesi. Rezultatet e analizave raportohen rregullisht në komitetin e menaxhimit të rrezikut në nivel të bankës dhe në bordin drejtues. Përgjatë 2015, ekspozimi i rrezikut të normës së interesit ishte brenda limiteve të miratuara.

Adekuatshmëria e kapitalit

Adekuatshmëria e kapitalit të bankës kalkulohet në baza të rregullta dhe raportohet tek menaxhmenti i bankës përmes komitetit të menaxhimit

të rrezikut, bashkë me parashikimet e ardhshme që të sigurohet pajtueshmëri me kërkesat rregullative të adekuatshmërisë së kapitalit. Menaxhimi i adekuatshmërisë së kapitalit bëhet duke u mbështetur në politikën e bankës dhe në përputhje me rregulloren e bankës qendrore mbi adekuatshmërinë e kapitalit.

Gjatë tërë vitit 2015, banka ka qenë mirë e kapitalizuar duke mbajtur raportet e adekuatshmërisë së kapitalit mbi limitet e parapara me politika të bankës dhe rregulla bankare. Gjatë vitit 2015, raporti i adekuatshmërisë së totalit të kapitalit sipas definicioneve të rregullatorit vendor ishte mesatarisht 18.9%, që tejkalon dukshëm minimumin e përcaktuar prej 12%. Në anën tjetër, raporti i adekuatshmërisë së kapitalit të klasit të parë ishte mesatarisht 15.8%, që gjithashtu tejkalon minimumin prej 8% të BQK-së.

Gjatë vitit 2015, agjencioni “FitchRatings” ka konfirmuar klasifikimin e përgjithshëm kreditor të Bankës ProCredit në “B+”.

Menaxhimi i rrezikut operacional dhe i mashtrimit

Në pajtueshmëri me principet e Basel II dhe rregullat përkatëse të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, rreziku operacional definohet si rreziku nga humbja si rezultat i proceseve jo-adekuate internale, rreziku nga njerëzit si dhe nga sistemet dhe/ose ngjarjet nga jashtë. Ky definim gjithashtu përfshinë edhe rrezikun ligjor.

Banka menaxhon rrezikun operacional përmes politikave të dedikuara për këto rreziqe që përfshijnë Politikën e Menaxhimit të Rreziqeve Operacionale, atë për Parandalimin e Mashtrimeve, politikën e Sigurisë së Informatave, politikën e Nën-Kontraktimit, etj. Menaxhimi i këtij rreziku është i mbështetur nga trajnime intensive të punonjësve në të gjitha nivelet, që ka dëshmuar të jetë efektiv në zvogëlimin dhe mënjanimin e rrezikut operacional.

Për të zvogëluar rrezikun operacional dhe atë të mashtrimit, të gjitha proceset kryesore të bankës janë të dokumentuara në mënyrë të duhur dhe përmbajnë mekanizmat e nevojshëm të kontrollit. Parimet “katër-sy” dhe të ndarjes së detyrave në

mes departamenteve dhe funksioneve aplikohen kudo që është e nevojshme dhe e përshtatshme, në sistemet dhe proceset e bankës.

Vëmendje e madhe i kushtohet integritetit personal përmes zbatimit të kodit të mirësjelljes dhe programeve të trajnimit të dizajnuara me qëllim të promovimit të një kulture të transparencës dhe vetëdijes së rrezikut. Njohuritë mbi rrezikun operacional, të mashtrimit dhe të sigurisë së informacionit, si dhe kanalet për raportimin e ngjarjeve të këtyre rreziqeve, janë pjesë e trajnimeve të rregullta të stafit.

Banka përdor bazën së të dhënave të ngjarjeve të rrezikut përmes së cilës sigurohet që rreziqet operacionale dhe rastet e mashtrimeve adresohen në mënyrë sistematike, duke i dokumentuar masat korrektuese dhe preventive.

Si pjesë e kornizës së saj të menaxhimit të rrezikut operacional dhe të mashtrimit, banka bën vlerësime të rregullta të proceseve për identifikimin e rreziqeve dhe mungesave potenciale të kontrollit, që mund të zvogëlohen dhe kontrollohen me masa të duhura. Për më tepër, ndryshimet materiale në proceset dhe shërbimet e bankës, të reja apo aktuale, kalojnë përmes një procesi të rishikimit dhe aprovimit të rreziqeve. Gjithashtu, indikatorët kyç të rrezikut monitorohen nga rregullisht nga banka.

Parandalimi i shpëlarjes së parasë

Pjesë integrale e modelit tonë biznesor dhe vizionit shoqëror është edhe të vepruarit konform vlerave të larta etike. Banka ProCredit në Kosovë mbështet fuqishëm luftën kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Politika dhe procedurat kundër shpëlarjes së parave të bankës sonë janë hartuar për t'u siguruar që institucioni ynë është në përputhje të plotë me kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin e Kosovës, rregulloret, rregullat dhe udhëzimet e industrisë për sektorin e shërbimeve financiare nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, për të zvogëluar rrezikun e përdorimit të produkteve bankare për lehtësimin e shpëlarjes së parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare në përgjithësi. Banka ProCredit, përpos politikës lokale, ka implementuar edhe politikën e Grupit

për luftimin e shpëlarjes së parave, e cila përbush kërkesat e legjislacionit gjerman dhe atij të BE-së.

Banka krijon relacion biznesore me klientë dhe ekzekuton transaksione bankare vetëm atëherë kur kupton qartë dhe dakordohet me qëllimin themelor të marrëdhënieve biznesore. Një mbrojtje shtesë e automatizuar ofrohet përmes përdorimit të tri moduleve të softuerit kundër shpëlarjes së parave: Siron Embargo, Siron KYC dhe Siron AML, module këto të prodhuara nga Tonbeller AG.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, përkatësisht ligjit Nr. 04/L-178, çfarëdo transaksioni në para të gatshme që është e barabartë/ apo tejkalon shumën 10,000 euro banka e raporton tek Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF-K) në baza të rregullta. Po ashtu, çfarëdo përpjekje për ekzekutimin e transaksioneve që ngjall dyshime për shpëlarje të parave, financim të terrorizmit ose ndonjë aktivitet tjetër kriminal, banka e raporton tek NJIF-K.

Në bankën tonë, përgjegjësia për luftimin e shpëlarjes së parave ushtrohet nga Njësia Kundër Shpëlarjes së Parave (Njësia KSHP). Kjo njësi përbëhet nga 4 zyrtarë kundër shpëlarjes së parave, të cilët mbështesin Udhëheqësin dhe Zëvendës-Udhëheqësin Kundër Shpëlarjes së Parave. Njësia KSHP e bankës sonë, në bashkëpunim me Departamentin e Grupit Kundër Shpëlarjes së Parave, kryen një vlerësim të rrezikut, duke azhurnuar politikën kundër shpëlarjes së parave në baza vjetore. Një pjesë e rëndësishme e programit tonë për luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit është trajnimi i stafit të bankës sonë. Zbatimi i masave të suksesshme dhe veprimeve për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit në bankë varen direkt nga dinamika dhe cilësia e trajnimit të punonjësve të bankës për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Prandaj, përveç zyrtarëve në Njësinë KSHP të gjithë punonjësit e bankës pranojnë trajnime intenzive (kombëtare e ndërkombëtare) për më të rehat nga fusha e luftimit të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.



Punëtorët dhe zhvillimi i tyre

Banka ProCredit dëshiron që të bëjë ndryshim në treg, jo vetëm në kuptimin e cilësisë së shërbimeve financiare që ofron, por gjithashtu në kuptimin të kualifikimeve të personelit. Prandaj, banka investon vazhdimisht në zhvillimin e burimeve njerëzore. Ne i kushtojmë vëmendje të veçantë procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes, si dhe ofrimin e trajnimeve të rregullta për personelin tonë sepse besojmë se kompetencat dhe përkushtimi i personelit tonë është rëndësi thelbësore për ofrimin e shërbimit me cilësi të lartë për klientët, në mënyrë të përgjegjshme.

Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve vazhdimisht ndihmon punëtorët për të ngjitur nivelin e cilësisë në performancën e tyre duke ofruar mundësi të ndryshme për zhvillim. Prosesi i vlerësimit është një strategji e përgjithshme e bankës për vlerësimin e performancës së punëtorëve. Kjo, së bashku me strukturën e pagave dhe mundësitë për trajnime shërbejnë si mjet i mirë për të zhvilluar dhe përmirësuar performancën e personelit tonë dhe si rezultat kjo gjithashtu ka përmirësuar kulturën dhe performancën e përgjithshme të bankës.

Zhvillimi i personelit është fuqia kyçe e Bankës ProCredit. Vetëm personeli profesional dhe i trajnuar mirë mund të ofrojë shërbime të shkëlqyeshme për klientë. Investimi për trajnimin dhe zhvillimin e personelit është ndarë në tre segmente kryesore siç janë Akademitë dhe Qendrat e Gjuhëve të ProCredit-it, trajnimet e specializuara dhe trajnimet e tjera.

Trajnimi dhe akademitë e ProCredit

Trajnime të avancuara mbahen në Akademinë Rajonale të ProCredit në Veles, Maqedoni dhe në Akademinë Qendrore në Furth, Gjermani. Pasi gjuhë angleze është gjuhë e dytë e punës në Bankën ProCredit, kurset e gjuhës angleze ofrohen për personelin në nivele të ndryshme. Vetëm këtë vit, 56 punonjës kanë qenë pjesëmarrës në akademitë për kurset e gjuhës angleze.

Akademitë ofrojnë ambient të pasur shumëkulturore dhe tejet të përshtatshëm ku trajnime profesionale ofrohen për menaxherët, menaxherët e nivelit të mesëm dhe personelin e ardhshëm të menaxhmentit. Këto kurse të trajnimit

organizohen në blloqe të ndryshme, që mbahen përgjatë një periudhe prej një viti për akademinë rajonale dhe tre vite për akademinë qendrore.

Në vitin 2015, 12 menaxherë diplomuan nga këto akademi: dhjetë nga akademia rajonale në Maqedoni dhe dy nga Akademia e ProCredit në Gjermani. Edhe 18 të tjerë janë duke vijuar akademinë në Gjermani, dhe 8 në Maqedoni.

Trajnimet e Specializuara:

Rritja së bashku me klientët tanë si dhe, kuptimi i nevojave të tyre financiare dhe i bizneseve të tyre është në qendër të modelit afarist të bankës ProCredit. Prandaj, ne kemi vazhduar mbajtjen e trajnimeve të specializuara për Këshilltarët e Klientëve të Biznesit, në mënyrë që të përmbushen nevojat e klientëve dhe të ofrohen shërbimet më të mira për ta. Këto trajnime filluan më 2014 dhe vazhduan përgjatë gjithë vitit 2015. Në kuadër të trajnimeve të specializuara, këtë vit janë trajnuar të gjithë këshilltarët e klientëve privat për të rritur edhe më tej efikasitetin operacional që e mundëson investimi i bankës në teknologjitë më bashkëkohore, dhe për të edukuar klientët për të përdorur një game të gjerë kanalesh për nevojat e tyre bankare për një bankim sa më të përshtatshëm, më të shpejtë, dhe më të sigurt.

Trajnimet tjera:

Kurse tjera që janë mbajtur gjatë vitit 2015 kanë qenë: trajnimi për udhëheqje, trajnim i këshilltarëve të klientëve privatë dhe të bizneseve lidhur me financimet e gjelbra.

Mbi të gjitha, Banka ProCredit në Kosovë, ka investuar afërsisht 765.000 € në trajnim dhe zhvillim të personelit në vitin 2015. Banka do të vazhdojë të investojë në zhvillimin profesional të stafit dhe zhvillimin e kapaciteteve këshilluese, duke ndërtuar qendrën e trajnimeve në Prizrenit.

Programi për Bankierë të Rinj

Programi për Bankierë të rinj, në vitin 2015 është mbajtur për herë të pesëmbëdhjetë. Ky program mbahet në Kosovë me kandidatë që vijnë nga Kosova dhe rajoni, i njohur si program internacional. Përmes Programit për Bankierë të Rinj, Banka ProCredit ofron mundësi trajnimi për kandidatë të cilët dëshirojnë të kontribuojnë me pikëpamjet e tyre dhe të menduarit kritik në një bankë të suksesshme. Ne jemi gjithashtu të hapur për kandidatë me profile të tjera të cilët janë të interesuar për një qasje tjetër në shërbime bankare, që bazohet në standarde të larta profesionale dhe kuptim të hollësishëm të nevojave të klientëve tanë.

Banka kërkon njerëz tejet të motivuar, të talentuar dhe miqësor, me përvoja të ndryshme akademike, që flasin rrjedhshëm gjuhën angleze – kandidatë të cilët janë të gatshëm të përfshihen, të mësojnë dhe të zhvillohen brenda institucionit.

Struktura e Programit

Ne besojmë se njeriu mund të mësojë atë që nuk e di! Prandaj, Banka ProCredit ofron Programin për Bankierë të Rinj, një mundësi unike për zhvillim gjithëpërfshirës dhe punësim të kandidatëve të profileve të ndryshme. Roli i bankave në shoqëri shkon përtej ndikimit ekonomik në vend.

Programi për Bankierë të Rinj sfidon kandidatët të zgjerojnë njohuritë me kurse të cilat mbulojnë tema më të përgjithshme, siç janë: filozofia e të bërit biznes, roli i ndërmjetësisimit financiar dhe edukimi në zhvillimin e një vendi, qasja jonë ndaj mbrojtjes së mjedisit, ndikimi i globalizimit në mënyrën e funksionimit të një shoqërie dhe shumë fusha të tjera, përfshirë kodin tonë të etikës dhe qasjes së përgjegjshme ndaj shoqërisë.

Mbi të gjitha, ajo çka e bën Programin për Bankierë të Rinj unik dhe tërheqës është mënyra në të cilën shtjellohen këto fusha. Mësimet Interaktive, diskutimi i hapura, puna në grup dhe projekte, janë rutina e përditshme e programit. Prandaj, programi dhe metodat e punës janë të dizajnuara ashtu që kandidatët të zhvillohen si në aspektin personal po ashtu edhe në aspektin profesional dhe të përshtaten më mirë me ambi-

entin e punës. Programi zgjat 6 muaj dhe mbahet në Qendrën tonë të Trajnimit. Kandidatët e përzgjedhur nga banka ProCredit për pjesëmarrje në program marrin paga përgjatë periudhës prej gjashtë muajsh.

Ka shanse të mëdha që kandidatëve që e përfundojnë me sukses programin, t'iu ofrohet punë në Bankën ProCredit në Kosovë.

Ndërtimi i marrëdhënieve

Si në vitet e kaluara, mundësitë për punë praktike janë ofruar dy herë në vit, gjatë sezonit të verës dhe dimrit, për studentë nga universitetet publike dhe ato më prestigjioze private. Pasi puna praktike është pjesë e detyrueshme e kurrikulës së shumicës së universiteteve në Kosovë, duke ofruar mundësi për punë praktike për studentët, Banka ProCredit luan rol të rëndësishëm me kontributin e saj në përpjekjet e edukimit financiar në vend. Programi për Punë Praktike është mundësi e mrekullueshme që studentët të mësojnë për bankën dhe të vendosin nëse pas diplomimit, do të dëshirojnë të marrin pjesë në procesin e përzgjedhjes për Programin për Bankierë të Rinj, i cili është pikë hyrëse për një karrierë në Bankën ProCredit.

Në vitin 2015, 100 studentëve u është ofruar punë praktike tre mujore në bankë, me qellim që t'ju ndihmohet t'i zhvillojnë në praktikë njohuritë e marra në fakultet në mënyrë që të integrohen më lehtë në tregun e punës.

Hapat tonë drejtë një mjedisi më të pastër



Një parim tjetër i rëndësishëm në thelb të vizionit të politikës sonë për zhvillim është qëndrueshmëria ekologjike dhe shoqërore e zhvillimit ekonomik që ne e mbështesim. Banka ProCredit ka zhvilluar një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit mjedisor, të bazuar në tri shtylla: Shtylla e parë përbëhet nga masat e brendshme që kanë për synim zvogëlimin e ndikimit negativ mjedisor nga vet bankat, duke e zvogëluar konsumin e tyre të energjisë dhe materialeve dhe duke e minimizuar prodhimin e mbeturinave.

Shtylla e dytë ka për synim të zvogëlojë ndikimin e jashtëm të operacioneve tona kredidhënëse nëpërmjet një vlerësimi të hollësishëm të ndikimit mjedisor të aktiviteteve të klientëve. Shtylla e tretë i referohet zhvillimit të portfolios të 'kredive të gjelbra' nëpërmjet financimit të investimeve të klientëve në efikasitet të energjisë, në energji të ripërtëritshme dhe në projekte të qëndrueshme në aspektin mjedisorë.

Derisa jemi të zotuar që të kemi ndikim në mjedis - ne i masim në baza të rregullta nivelet e konsumit të energjisë dhe të ujit, si dhe sasinë e letrës dhe materialeve tjera që përdoren në operacionet ditore të bankës.

Po ashtu ndikim kanë edhe kushtet e zyrave tona, efektiviteti i pajisjeve që përdorim dhe efikasiteti i automjeteve tona.

Duke iu falënderuar përkushtimit të personelit dhe ndryshimeve të bëra në proceset e punës krahas përmirësimeve teknologjike, Banka ProCredit tashmë ka arritur rezultate të dukshme.

- Sasia e energjisë elektrike e konsumuar ka rënë për 5.2 %.
- Konsumi vjetor i naftës për ngrohje ka rënë për 13.6 %
- Konsumi i letrës ka rënë për 39.4 %

Për më tepër, në vitin 2015, me qëllim të promovimit të politikës së ProCredit-it e cila ka për qëllim që të kufizojë ndikimin negativ të aktiviteteve tona në mjedis, banka ka lansuar nismën për zvogëlimin e përdorimit të qeseve të plastikës. Gjatë kësaj fushate, banka ProCredit në Kosovë ka shpërndarë 150,000 qese të punuara 100% nga pambuku organik. Banka ProCredit ka fituar në nivel korporate çmimin e parë për Përgjegjësi Shoqërore Korporative në Kosovë për vitin 2015 si rezultat i aktiviteteve të saja të shumta edukative dhe vetëdijesuese në fushën e mbrojtjes mjedisore.

Perspektiva e bankës për vitin 2016

Në vitin 2015 zhvillimi ekonomik arriti në 3.5 %, që ishte një zhvillim i rëndësishëm në krahasim me rritjen e ngadalët ekonomike gjatë vitit 2014.

Parashikimet për rritjen ekonomike janë të bazuara në pritjet për projektin investiv të turizmit të Brezovicës, projektet e reja kapitale të financuara nga donatorët, një përmirësim të qëndrueshëm në kreditë bankare për sektorin privatë dhe hapat për të reduktuar korrupsionin dhe për të përmirësuar mjedisin e të bërit biznes. Megjithatë, e ardhmja duhet të marrë parasysh paqëndrueshmërinë politike e cila mund të manifestohen përmes rreziqeve në vonesa të legjislacionit të rëndësishëm në këtë mënyrë pengon pritjet pozitive.

Në dy vitet e fundit ndikimi pozitiv i të hyrave të vazhdueshme nga remitancat ka shërbyer si një amortizator i problemeve të ndryshme ekonomike dhe politike dhe kjo mund të vazhdojë edhe vitin 2016. Me supozimet se përmasat e problemeve politike nuk do të rritet, ne presim performancë më të mirë e bizneseve në Kosovë.

Në këtë drejtim, Banka ProCredit në Kosovë me investimet e bëra në vitin 2015 në infrastrukturën e

Zonave 24/7, ka krijuar avantazh të rëndësishëm konkurrues që do të reflektohet përmes shërbimeve efikase dhe të besueshme për klientët e saj, çmime konkurruese për biznesin e pagesave dhe në përgjithësi me paketën e plotë të shërbimeve bankare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë dhe ku kontributi në zhvillim është më i lartë. Kreditë investuese, kreditimit bujqësore dhe kreditimi Eko do të vazhdojnë të dominojnë biznesin e kreditimit në vitin 2016.

Ndërkohë, shërbimet për individët privatë do të vazhdojnë të përditësohen për të arritur standartet e institucioneve financiare modern si dhe të jenë në një linjë me pritshmërit në rritje të klientëve tanë.

Në vitin 2016 ne presim që objekti i qendrës sonë të trajnimeve dedikuar stafit tonë të jetë plotësisht funksional. Stafi mire i trajnuar me rolin e tyre në këshillim dhe rrjetin e modernizuar, janë shenja të rëndësishme dalluese të Bankës ProCredit në Kosovë, të cilat do të vazhdojnë të jenë themeli i suksesit tonë edhe në vitet në vijim.



Pasqyra Financiare

Pasqyra Financiare deri më 31 Dhjetor 2015

Informatat e përgjithshme

Bordi i Drejtorëve

Z. Borislav Kostadinov, Kryetar

Znj. Helen Alexander

Z. Rainer Ottenstein

Znj. Birgit Storz

Z. Qendrim Gashi

Z. Ilir Aliu

Zyra e regjistruar

Bulevardi Nëna Terezë, Nr. 16

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

Raporti i Audituesve të Pavarur

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Përmbledhëse	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	2
Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë	3
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	4
Shënimet për Pasqyrat Financiare.....	5 - 46



KPMG Albania Shpk Kosovo Branch
6, Pashko Vasa Street
Pristina, Kosovo

Telephone +381(38)246771
Telefax +381(38)610772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Aksionarit dhe Bordit të Drejtuesve të
ProCredit Bank sh.a

Prishtinë, 29 mars 2016

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të ProCredit Bank sh.a ("Banka") të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2015, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera përmbledhëse, ndryshimeve në ekuitet dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm i cili, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi ynë, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Bankës më 31 dhjetor 2015, rezultatin e saj financiar dhe rrjedhjen e parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch
6, Pashko Vasa Street,
Pristina, Kosovo

	Shënim	2015	2014
Të ardhurat nga interesat	7	46,083	55,338
Shpenzimet nga interesa	7	(3,124)	(9,123)
Të ardhurat neto nga interesi		42,959	46,215
Të ardhurat nga tarifa dhe komisione	8	10,495	10,132
Shpenzimet për tarifa dhe komisione	8	(4,025)	(3,769)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione		6,470	6,363
Fitimet/(humbjet) neto nga letrat me vlerë për shitje		3	(3)
Fitimet neto të këmbimit të monedhave të huaja		515	553
Të ardhurat e tjera operative		1,384	1,515
Humbje nga rënia e vlerës së kredive	13	(3,143)	(11,478)
Shpenzimet administrative dhe të tjera operative	9	(27,605)	(26,496)
Fitimi para tatimit		20,583	16,669
Shpenzimet e tatimit ne fitim	10	(2,213)	(2,116)
Fitimi neto për vitin		18,370	14,553
Të Ardhurat e Tjera Përmbledhëse:			
Zërat që janë ose mund të riklasifikohen në fitim ose humbje			
Rezerva e vlerës së drejtë (aktivet financiare për shitje)	10	58	205
Të ardhura totale përmbledhëse për vitin		18,428	14,758

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 46, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

	Shënim	2015	2014
Aktivitet			
Paraja e gatshme dhe saldot me Bankat Qendror	11	164,808	162,051
Kredi dhe paradhënie për bankat	12	81,861	110,434
Kredi dhe paradhënie për klientët	13	436,730	415,512
Aktivitet financiarë të vlefshme për shitje ('VPS')	14	88,012	94,995
Aktivitet e patrupëzuara	15	621	848
Prona dhe pajisjet	16	16,056	14,408
Aktive të tjera financiare	17	1,941	2,716
Tatim fitimi i parapaguar	10	330	-
Aktive për tatimin e shtyrë	10	544	-
Aktive të tjera	18	890	789
Total i aktiveve		791,793	801,753
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	19	249	282
Detyrime ndaj klientëve	20	678,057	686,211
Hua dhe detyrime të varura	21	15,668	14,825
Tatim fitimi i pagueshëm	10	-	371
Detyrime për tatimin e shtyrë	10	-	193
Detyrime të tjera financiare	22	1,267	1,107
Detyrime të tjera	23	2,116	2,756
Totali i detyrimeve		697,357	705,745
Ekuiteti i aksionarit			
Kapitali aksionar	24	61,346	61,346
Premia nga aksionet	24	4,204	4,204
Rezervat kontigjente	24	511	511
Rezerva e vlerës së drejtë	24	(6)	(64)
Fitimet e mbajtura		28,381	30,011
Ekuiteti total i aksionarëve		94,436	96,008
Total detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve		791,793	801,753

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 46, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi Menaxhues më 29 mars 2016 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

Ilir Aliu
Kryeshef Ekzekutiv

Rezak Fetaj
Menaxher i lartë

	Shënim	2015	2014
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi përpara tatimit		20,583	16,669
Rregullime për:			
Zhvlerësimin	16	2,080	2,569
Amortizimin	15	863	762
(Fitimi)/humbja nga çregjistrimi i pajisjeve dhe pasurive		(41)	96
Humbje nga rënia e vlerës së kredive	13	3,143	11,478
Të ardhurat nga interesat	7	(46,083)	(55,338)
Shpenzimet për interesa	7	3,124	9,123
		(16,331)	(14,641)
Ndryshimet në:			
Kredi dhe paradhënie me bankat		20,012	(20,004)
Kredi dhe paradhënie me klientët		(25,029)	12,127
Aktive të tjera		(101)	289
Aktive të tjera financiare		775	(1,108)
Rezerva statutorë në BQK		18,089	(3,513)
Detyrime ndaj bankave		(33)	(168)
Detyrime ndaj klientëve		(5,692)	24,821
Detyrime të tjera		(640)	(651)
Detyrime të tjera financiare		160	1,575
		(8,790)	(1,273)
Interesi i pranuar		46,502	57,499
Interesi i paguar		(5,712)	(13,541)
Tatimet e paguara		(3,657)	(1,333)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		28,343	41,352
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Të hyra neto nga shitja e aktiveve VPS		7,296	74,250
Të hyra nga shitja e pasurive dhe pajisjeve		4,150	1,676
Blerje të pasurive dhe pajisjeve		(7,837)	(1,781)
Blerje të aktiveve të patrupëzuara		(636)	(441)
Paraja neto nga aktivitetet investuese		2,973	73,704
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
Të hyra/(ripagime) nga huamarrjet		951	(9,955)
Kapital i ri i nënshkruar		-	5,000
Dividendë të paguar		(20,000)	(20,000)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese		(19,049)	(24,955)
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		12,267	90,101
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		209,715	119,614
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	11	221,982	209,715

Pasqyra e rrjedhjes së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 46, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

	Kapitali aksionar	Premia e aksionit	Rezerva konti-gjente	Fitimet e mbajtura	Rezerva e vlerës së drejtë	Totali
Gjendja më 1 janar 2014	56,346	4,204	511	35,458	(269)	96,250
Transaksione me aksionarin e Bankës:						
Dividendë të paguar	-	-	-	(20,000)	-	(20,000)
Kapital i nënshkruar	5,000	-	-	-	-	5,000
Kontribute dhe shpërndarje	5,000	-	-	(20,000)	-	(15,000)
Totali i të ardhurave përmbledhëse						
Fitimi i vitit	-	-	-	14,553	-	14,553
Të ardhura të tjera përmbledhëse						
Ndryshimi në vlerën e drejtë të VPS	-	-	-	-	205	205
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	-	205	205
Totali i të ardhurave përmbledhëse	-	-	-	14,553	205	14,758
Gjendja më 31 dhjetor 2014	61,346	4,204	511	30,011	(64)	96,008
Transaksione me aksionarin e Bankës:						
Dividendë të paguar	-	-	-	(20,000)	-	(20,000)
Kontribute dhe shpërndarje	-	-	-	(20,000)	-	(20,000)
Totali i të ardhurave përmbledhëse						
Fitimi i vitit	-	-	-	18,370	-	18,370
Të ardhura të tjera përmbledhëse						
Ndryshimi në vlerën e drejtë të VPS	-	-	-	-	58	58
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	-	58	58
Totali i të ardhurave përmbledhëse	-	-	-	18,370	58	18,428
Gjendja më 31 dhjetor 2015	61,346	4,204	511	28,381	(6)	94,436

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet duhet të lexohet së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 46, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

1. Entiteti raportues

ProCredit Bank sh.a në Kosovë ('Banka') është themeluar më 9 dhjetor 1999, dhe ka nisur operacionet më 12 janar 2000. Banka është licencuar për të operuar si Bankë në të gjitha fushat bankare në Kosovë sipas rregullave të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (AQBK) dhe është subjekt i Ligjit mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Jobankare, Nr. 04/L-093.

Banka është filial i ProCredit Holding AG & Co. KGaA (ProCredit Holding), e cila kontrollon 100% të aksioneve votuese të Bankës.

ProCredit Bank Sh.a ishte banka e parë e licencuar në Kosovë. ProCredit Bank sh.a. është një bankë tregtare e orientuar drejt zhvillimit e cila i ofron shërbime ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe individëve privatë. Në operacionet e saj Banka i përmbahet disa parimeve bazë si: vlerësimi i transparencës në komunikimin me klientët, përpjekja për minimizim të ndikimit ekologjik dhe sigurimi i shërbimeve, të cilat bazohen si në kuptimin e situatave të çdo klienti, edhe në analizën e bazuar financiare.

Selia e Bankës është e vendosur në Bulevardin Nëna Terezë, Nr. 16, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Gjatë vitit 2015, Banka operon me degë, qendra shërbimi, pika shërbimi dhe me Zonat 24/7 në mënyrë që t'iu sigurojë konsumatorëve shërbime më të mira dhe më të arritshme.

Përbërja e Bordit Drejtues më 31 dhjetor 2015:

- Z. Borislav Kostadinov, Kryetar
- Znj. Helen Alexander, Anëtare
- Z. Rainer Ottenstein, Anëtar
- Znj. Birgit Storz, Anëtare
- Z. Qendrim Gashi, Anëtar
- Z. Ilir Aliu, Anëtar dhe Kryeshef Ekzekutiv

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të), lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe nga struktura e tij paraardhëse. Përveç kësaj, janë aplikuar dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve për Raportimin Fi-

nanciar (KIRFN) dhe nga struktura e tij paraardhëse. Detajet e politikave kontabël të Bankës, duke përfshirë ndryshimet gjatë vitit, janë përfshirë në shënimin 3.

(b) Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të cilat janë matur me vlerën e drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare paraqiten në EUR, e cila përbën dhe monedhën funksionale të Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakuar në mijëshen më të afërt, përveçse kur shprehet ndryshe.

(d) Përdorimi i gjykimeve dhe i vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, manaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe mbi shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të kenë ndryshim nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi elementët e rëndësishëm me pasiguri në vlerësime dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël me efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 6.

3. Politika të rëndësishme kontabël

Përveç ndryshimeve të përmendura, politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në këto pasqyra financiare nga Banka.

(a) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një

periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivitet ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo lëshimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse (ATP) përfshijnë:

- Interesat nga aktive ose detyrime financiare të cilat maten me koston e amortizuar të llogaritur me anë të metodës së normës efektive të interesit; dhe
- Interesa nga letra me vlerë të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

(b) Komisione dhe tarifa

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv (shih politikën (c)).

Të ardhurat e tjera nga komisionet, përfshirë komisionet e shërbimit të llogarisë, komisionet për menaxhim investimi, komisionet për shitje dhe vendosje depozite njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve. Nëse angazhimi për një hua nuk pritet të zvogëlojë huanë, atëherë komisionet e angazhimit të huasë njihen në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së angazhimit.

Shpenzimet e tjera për komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

(c) Qiratë operative

Totali i pagesave të kryera për qiratë operative njihet në pasqyrën e fitim/humbjeve sipas metodës lineare përgjatë jetës së qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimeve për qira, përgjatë afatit të qirasë.

(d) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja janë njohur dhe kthyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në monedhën funksionale të Bankës me kursin në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundvitit.

Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi në monedhën funksionale njihen në fitim ose humbje.

(e) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin e vitit përmban tatimin e vitit aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e fitim humbjeve të periudhës me përjashtim kur i referohet zërave të cilët njihen direkt në kapital ose te të ardhurat e tjera përmbledhëse.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Tatimi mbi fitim (vazhdim)

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose të arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose humbjet për periudhën dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme. Matet duke përdorur normat e tatimit në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që dalin midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin në momentin e njohjes filletare të aktiveve ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbejnë një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitimin/humbjen kontabël dhe as atë të tatueshme,

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet/kreditet e mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme, deri në masën që është e mundur që të kemi të ardhura të tashme kundrejt të cilave ky aktiv tatimor pritet të përdoret. Aktiviteti tatimor i shtyrë rishikohet në cdo periudhë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka mundësi që përfitimi i lidhur nga tatimi të mund të realizohet.

Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit të cilat janë parashikuar të zbatohen mbi diferencat e përkohshme në momentin e kthimit të tyre, duke përdorur normat e tatimit në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompesojnë njëra-tjetrën kur ka një të drejtë ligjore të zbatueshme për të kompesuar aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatimet mbi të ardhurat të vëna nga i njëjti autoritet tatimor, ose nga autoritete të ndryshme tatimore që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet aktuale në baza neto përndryshe aktivet dhe detyrimet tatimore do të realizohen njëkohësisht.

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozimet dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

(f) Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, depozitat, dhe huatë e detyrimet e varuara në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (duke përfshirë dhe blerjet e shitjet e rregullta) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo lëshimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Aktivet financiare

Banka klasifikon aktivet e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe llogari të arkëtueshme; dhe
- Aktive të vlefshme për shitje.

Shih (g), (h), dhe (i).

Detyrimet financiare

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare (përvëçar garancive dhe angazhimeve për hua) si të matura me kosto të amortizuara. Shih (l) dhe (p).

(iii) Çregjistrimi

Aktivet financiare

Banka çregjistron një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale për rrjedhjet e parave nga aktiviteti janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktiviteti financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetin financiar, ose ku Banka nuk transferon dhe nuk mban asnjë nga rreziqet apo përfitimet e pronësisë si dhe nuk ruan kontrollin ndaj aktivitetit financiar.

Në momentin e çregjistrimit të një aktiviteti financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit (ose vlerës së mbartur që i caktohet pjesës së aktivitetit të çregjistruar) dhe shumës së (i) pagesës së arkëtuar (përfshirë çdo aktiv të ri të përfituar duke i zbritur detyrimin e ri të presupozuar) dhe (ii) fitimit ose shpenzimeve të akumuluar që njihen tek të ardhura të tjera përmbledhëse njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo interes në aktivitetin financiar të transferuar të cilat plotësojnë kriteret për t'u çregjistruar, që krijohet ose mbahet nga Banka, njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

(iv) Kompensimi

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë, dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompesuar shumën dhe ajo synon ose të shlyejë ato në baza neto, ose të realizojë aktivitetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF.

(v) Matja me kosto të amortizuar

'Kostoja e amortizuar' e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose pasivi të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mosekzekutimit të tij.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në treg aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me aktivin apo detyrimin ndodhin me shpeshtësi e volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin. Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - përshembull vlera e drejtë e pagesës së kryer ose të arkëtuar.

Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk përcaktohet nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të ngjashëm dhe nuk bazohet as në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna të njohura në tregje, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, dhe rregullohet për diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Në vijim, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave siç duhet gjatë kohëzgjatjes së instrumentit, por jo më vonë se periudha kur vlerësimi është plotësisht i mbështetur me të dhëna të njohura në treg ose kur mbyllet transaksioni.

Nëse një aktiv ose detyrim matur me vlerën e drejtë ka çmim të ofruar dhe çmim të kërkuar, Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmimin e kërkuar.

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në momentin e kërkesës, e cila zbritet nga data e parë kur do të kërkohej pagesa e depozitës.

Banka njuh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës së raportimit gjatë të cilës ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit
Zhvlerësimi i kredive dhe paradhënieve

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare janë zhvlerësuar.

Një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare zhvlerësohen kur ka evidenca objektive zhvlerësimi si pasojë e një ose disa ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit ('ngjarje humbjeje') dhe që kjo ngjarje humbjeje ka një impakt në flukset e ardhshme të parasë të këtij aktivi financiar ose grup aktivesh financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Kriteret e përdorura nga Banka për të vendosur nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë:

- Mospagim i detyrimeve kontraktuale të principalit (kryegjësë) ose interesit;
- Vështirësi në flukset e rrjedhjes së parasë të përjetuara nga huamarresi (si për shembull, raporti i ekuitetit, përqindjet e të ardhurave neto mbi shitjet);
- Shkelja e kushteve të kontratës dhe të kredisë;
- Fillimi i procedurave të falimentimit;
- Përkeqësimi i pozicionit konkurrues të huamarrësit;
- Përkeqësimi i vlerës së kolateralit.

Periudha e vlerësuar ndërmjet humbjes që ndodh dhe identifikimit të saj përcaktohet nga menaxhmenti lokal për secilin portofol të identifikuar. Në përgjithësi, periudhat e përdorura variojnë midis tre dhe 12 muajve, dhe në raste të veçanta, përdoren periudha më të gjata.

Banka fillimisht vlerëson nëse ka dëshmi objektive për zhvlerësimin individual të aktiveve financiare që janë individualisht të rëndësishme, si dhe zhvlerësimin individual ose kolektiv për aktivet financiare që nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse Banka përcakton se nuk ka dëshmi objektive për zhvlerësimin individual të një aktivi financiar, qoftë i rëndësishëm ose jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe vlerëson në mënyrë kolektive zhvlerësimin e tyre. Aktivet që janë vlerësuar individualisht për zhvlerësim dhe për të cilat është njohur apo vazhdon të njihet një humbje nga zhvlerësimi, nuk përfshihen në vlerësimin kolektiv të zhvlerësimit.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të matura me kosto të amortizuara llogariten si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme (duke përfshirë humbjet kreditore që nuk kanë ndodhur) të skontuar me normën filltare efektive të interesit të aktivitetit. Vlera kontabël e aktivitetit ulet nëpërmjet përdorimit të një llogarie zbritjeje dhe shuma e humbjes njihet në fitimin ose humbjen e vitit.

Llogaritja e vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të mjeteve monetare të një aktivi financiar të vendosur si kolateral pasqyron flukset monetare që mund të rezultojnë nga ekzekutimi, minus kostot për përfundimin dhe shitjen e kolateralit, nëse konfiskimi është i mundshëm.

Për qëllimet e një vlerësimi kolektiv të zhvlerësimit, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë (në bazë të procesit të kategorizimit të Bankës që konsideron llojin e aktivitetit, industrinë, vendndodhjen gjeografike, llojin e kolateralit, statusin e detyrimit të kaluar dhe faktorët e tjerë relevantë). Këto karakteristika janë të rëndësishme për përllogaritjen e flukseve të mjeteve monetare për grupet e aktiveve të tilla duke qenë indikative për aftësinë e debitorëve për të paguar të gjitha shumat në mënyrën e duhur sipas kushteve kontraktuale të aktiveve që vlerësohen.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

Zhvlerësimi i kredive dhe paradhënieve (vazhdim)

Të gjitha ekspozimet kreditore me shumë të mbetur prej 30 mijë EUR ose më shumë (2014: 30 mijë EUR ose më shumë) vlerësohen individualisht ndërsa ekspozimet kreditore nën këtë nivel janë konsideruar si jo të mëdha dhe vlerësohen në një bazë kolektive duke treguar indikacione të ngjarjeve të humbjeve. Për ekspozimet kreditore e zhvlerësuar jo të mëdha, llogariten nivelet e mëposhtme bazuar në përvojën historike të Bankës në mjedise të ngjashme ekonomike.

	Niveli i lejimit 2015	Niveli i lejimit 2014
ditë vonesa 0-30 ditë	1.99%	1.45%
ditë vonesa 31-90 ditë	55%	45%
ditë vonesa > 91 ditë	75%	70%
ditë vonesa > 180 ditë	90%	90%

Flukset e ardhshme të mjeteve monetare të një grupi aktivesh financiare të cilat janë vlerësuar në baza kolektive për zhvlerësim, përllogariten në baza të flukseve kontraktuale të aktiveve në Bankë dhe përvojës historike të humbjes për aktivet me karakteristika të rrezikut kreditor të ngjashme me ato në Bankë. Përvoja e humbjes historike përshtatet në baza të të dhënave të tanishme të vëzhgueshme për të reflektuar efektet e kushteve të tanishme të cilat nuk kanë ndikuar në periudhën në të cilën bazohet përvoja e humbjes historike dhe për të larguar efektet e kushteve në periudhën historike e cila nuk ekziston aktualisht.

Përllogaritjet e ndryshimeve në flukset e ardhshme të mjeteve monetare për grupet e aktiveve duhet të reflektojnë dhe të jetë në përputhje të drejtpërdrejtë me ndryshimet në të dhënat përkatëse të vëzhgueshme nga periudha në periudhë (për shembull, ndryshimet në normat e papunësisë, çmimet e pronave, statusi i pagesës, ose faktorët e tjerë tregues për ndryshimet në probabilitetin e humbjeve në Bankë dhe në shtrirjen e tyre). Metodologjia dhe supozimet e përdorura në llogaritjen e flukseve të ardhshme monetare rishikohen rregullisht nga Banka për të reduktuar ndonjë dallim ndërmjet llogaritjeve të humbjes dhe përvojës aktuale të humbjes. Në rastet kur një kredi nuk mund të mblihdet, ajo cregjistrohet kundrejt provizionit përkatës për zhvlerësimin e kredisë.

Kreditë e tilla çregjistrohen pasi përmbushen të gjitha procedurat e nevojshme dhe pasi të jenë përcaktuar shumat e humbjes.

Nëse, gjatë një periudhe pas datës së raportimit, shumat e humbjes nga zhvlerësimi ulet dhe ulja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pas regjistrimit të zhvlerësimit (p.sh. një përmirësim në kategorizimin kreditor të debitorit), bëhet kthimi i humbjes nga zhvlerësimi i regjistruar më parë, duke rregulluar shumën e lejimit. Kjo shume njihet ne fitim humbje ose humbje në zhvlerësimin për humbjet nga kredia.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje

Banka vlerëson në cdo datë raportimi nëse ka dëshmi objektive se një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare janë zhvlerësuar. Në rastin e investimeve ne instrumente te kapitalit te klasifikuara si te vlefshme për shitje, një rënie e rëndësishme e zgjatur në kohë e vlerës së drejtë të investimit nën koston e tij konsiderohet si faktor për të përcaktuar nëse ka patur zhvlerësim te aktivitetit. Nëse ekzistojnë dëshmi të tilla për aktivet financiare te vlefshme për shitje, humbja kumulative e matur si diferencë ndërmjet koston së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus humbjet nga zhvlerësimi mbi atë aktiv financiar të regjistruar më parë në pasqyrën e fitimit dhe humbjes - largohet nga pasqyra e të ardhurave permbledhese dhe njihet në fitim dhe humbje. Zhvlerësimet që njihen ne fitim ose humbje per investimet e kapitalit nuk mund te kthehen mes fitimit ose humbjes. Humbjet nga zhvlerësimi të regjistruara në fitim dhe humbje në instrumentet e ekuitetit nuk ndërrohen përmes fitimit dhe humbjes. Nëse, në një periudhë pas datës së raportimit, vlera e drejte e instrumentit të borxhit klasifikuar si i vlefshem për shitje rritet, dhe rritja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga zhvlerësimi është regjistruar në fitim humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet përmes fitimit dhe humbjes.

(g) Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedha dhe kartmonedha në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(h) Kreditë dhe paradhëniet

Kreditë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose te përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë apo në një periudhë afatshkurtër.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe për klientet klasifikohen si hua dhe llogari të arkëtueshme.

Kreditë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kur Banka blen një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje për ta rishitur kete aktiv (ose një aktiv thelbësisht të ngjashëm), me një çmim fiks në një datë në të ardhmen transaksioni regjistrohet si paradhënie ose kredi dhe aktivi i lidhur me te nuk regjistrohet ne pasqyrat financiare të Bankës.

(i) Aktivet financiare të vlefshme për shitje

Letrat me vlerë të investimit maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit. Investimet e vlefshme për shitje janë aktive jo-derivative të cilat janë dizenuar si të tilla dhe nuk mund të klasifikohen në një kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të investimit përbëhen nga investime të kapitalit dhe borxhit. Letrat me vlerë të kapitalit të pa kuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbahen me kosto. Gjithë letrat e tjera me vlerë maten me vlerë të drejtë pas njohjes fillestare. Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metoden e interest efektiv. Te ardhurat nga dividendët njihen në fitim ose humbje kur Banka fiton të drejtën për ta përfituar këtë dividend. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit të letrave me vlerë të vlefshme për shitje, njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi njihen gjithashtu në fitim ose humbje (shih shënimin (f) (vii)).

Ndryshime të tjera në vlerën e drejtë, përveç humbjeve nga zhvlerësimi (shih shënimin (f)(vii)), njihen në të Ardhurat tjera Përmbledhëse dhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë brenda kapitalit. Kur investimi shitet, fitimi ose humbja e akumuluar nga shitja riklasifikohet në fitim ose humbje.

(j) Prona dhe pajisje

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Kostoja përfshin shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitetit.

Shpenzimet e mëposhme njihen vetëm nëse është e mundur që perfitimet ekonomike që i atribuohen atyre do të rrjedhin te Banka në të ardhmen si dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha kostot e tjera për riparime dhe mirëmbajtje i ngarkohen shpenzimeve operative të periudhës në të cilën kryhen.

Vlera kontabël e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, rishikohet për të përcaktuar zhvlerësimin kur ka ndryshime në ngjarjet të cilat tregojnë se vlera e mbartur nuk mund të rikuperohet. Nëse ka të dhëna të tilla, dhe vlera kontabel është më e madhe se vlera që pritet të rikuperohet, aktivet ose njësite gjeneruese të mjeteve monetare zhvlerësohen në vlerën e tyre të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, është vlera më e madhe mes vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së përdorimit. Për të përcaktuar vlerën e përdorimit, flukset e pritshme të mjeteve monetare skontoohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton një vlerësim aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rezikun që lidhet me këtë lloj aktiviteti.

Për një aktiv që nuk gjeneron flukse monetare të pavarura në masë të madhe, shumën e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përkasin aktivitetet. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e fitimit dhe humbje.

Toka dhe aktivet në ndërtim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i aktiveve ngarkohet në baza lineare në norma të përshkruara për alokimin e kostos së pronës dhe pajisjeve përgjatë jetës së dobishme të përllogaritur. Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen nga jeta e dobishme e përllogaritur së aktiveve të caktuara sipas tabelës në vijim:

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

Përshkrimi	Jeta e dobishme 2015	Jeta e dobishme 2014
Ndërtesat	15-40 vite	15-40 vite
Përmirësimet e pronës së dhënë me qira	Bazuar në kushtet e qirasë	Bazuar në kushtet e qirasë
Pajisjet elektronike	2-5 vite	2-5 vite
Mobilje dhe pajisje zyre	2-10 vite	2-10 vite

(j) Prona dhe pajisje (vazhdim)

Bazuar në procedurat e brendshme, toka dhe pajisjet me jetëgjatësi më të madhe se një vit shuma e të cilave është në prag të materialitetit prej EUR 50 (2014: EUR 50), do të njihen menjëherë si shpenzime.

Fitimet ose humbjet nga shitja e aktivitetit vendosen duke krahasuar cmimin me vlerën e mbetur. Keto përfshihen në të ardhura dhe shpenzime të tjera operative (sipas rastit) në fitim ose humbje.

(k) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivitetet e qëndrueshme të patrupëzuara regjistrohen nëse është e provueshme se të mirat e ardhshme ekonomike të cilat vijne prej këtij aktiviteti do të përfitohen nga Banka dhe kostoja e aktivitetit mund të matet në mënyrë të besueshme. Aktivitetet e qëndrueshme të patrupëzuara maten fillimisht me kosto. Vlerat e mbartura të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara rishikohen për zhvlerësim kur ka ngjarje ose ndryshime në rrethana të cilat tregojnë se vlerat e mbartura mund të mos jenë të rikuperueshme. Aktivitetet e qëndrueshme të patrupëzuara janë të përbëra tërësisht nga programe kompjuterike të cilat amortizohen duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme prej pesë vitesh.

(l) Aktive të mbajtura për shitje

Aktivitetet afatgjata, grupe të nxjerra jashtë përdorimit të përbëra nga aktivitetet dhe detyrimet, klasifikohen si të mbajtura për shitje nëse është shumë e mundshme që ato kryesisht të mbulojnë nga shitja e tyre e jo nga përdorimi i vazhdueshëm. Aktive të tilla, ose grupe të nxjerra jashtë përdorimit, maten me vlerën më të ulët mes asaj të mbartur dhe vlerës së drejtë, minus koston e shitjes.

(m) Depozitat dhe huatë e detyrimet e varura

Depozitat dhe huatë e detyrimet e varura janë burimet kryesore të Bankës për financim.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marreveshje për të riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo), marrëveshja kontabilizohet si një detyrim financiar, dhe aktiviteti vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat dhe huatë e detyrimet e varura maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(n) Provizionet

Një provizion njihet kur si rezultat i një ngjarje të shkuar, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv të tanishëm, që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që flukse të mirash ekonomike mund të kërkohen për të shlyer detyrimin. Provizionet vendosen duke skontuar flukset e pritshme në të ardhmen me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të pasasë dhe risqet specifike të detyrimit. Vlera kohore e skontimit njihet si kosto financiare.

(o) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për planin e pensioneve të administruar në mënyrë publike. Banka nuk ka detyime të tjera pas pagesës së këtyre kontributeve. Kontributet janë regjistruar si shpenzime të përfitimeve për punonjësit në momentin e duhur. Banka ka llogaritur dhe ka krijuar provizione për pushimet e pashfrytëzuara të punonjësve deri në fund të vitit.

(p) Garancitë financiare dhe angazhimet për huatë

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimburuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Angazhimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të paracaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

(q) Kapitali aksionar

(i) Kosto e emetimit të aksioneve

Kostot shtesë që i atribuohen direkt emetimit të aksioneve të reja, janë shfaqur në kapital si zbritje, neto nga tatimi dhe të hyrat.

(ii) Primi i lidhur me aksionin

Primi i aksioneve paraqet shtesën e kontributeve të pranuar që tejkalon vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

(iii) Dividendët mbi aksionet e zakonshme

Dividendët mbi aksionet e zakonshme janë regjistruar në kapital në periudhën në të cilën ato janë të aprovuara nga aksionarët e Bankës. Dividendët për vitin, që janë deklaruar pas datës së raportimit janë deklaruar si ngjarje të ndodhura pas datës së raportimit.

(r) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime ende të paadoptuara

Një numër standardesh, ndryshimesh dhe interpretimeve nuk kanë qënë ende efektive në fund të vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasyrave financiare. Ato që mund të jenë me rëndësi për Bankën janë paraqitur si më poshtë. Banka nuk planifikon t'i adoptojë këto standarde dhe ndryshime më herët.

SNRF 9 Instrumentat Financiarë

SNRF 9, publikuar në Korrik 2014, zëvendëson udhëzimin ekzistues të SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja. SNRF 9 paraqet udhëzime të rishikuara për klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke përfshirë një model të ri të humbjes së pritshme të kredisë për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kriteret e reja të përgjithshme mbrojtëse të kontabilitetit. Standardi gjithashtu jep udhëzime për njohjen dhe mos-njohjen e instrumenteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në dhe pas datës 1 Janar 2018, duke lejuar dhe aplikimin paraprak.

Banka ka filluar procesin e vlerësimit të ndikimit potencial në pasqyrat e saj financiare që rezultojn nga aplikimi i SNRF 9. Duke pasur parasysh natyrën e aktiviteteve të Bankës, ky standard pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 15 Te hyrat nga kontratat me klientët

SNRF 15 krijon një strukturë gjithëpërfshirëse për të përcaktuar se sa dhe kur e hyra duhet të njihet. Ky standard zëvendëson interpretimet aktuale të njohjes së të hyrave, duke përfshirë SNK 18 Të hyrat, SNK 11 Kontratat e ndërtimit dhe KIRFN 13 Programet e besnikërisë së klientëve. SNRF 15 është efektive për raportime vjetore për periudhat nga ose

pas 1 Janarit 2018, me lejim të adoptimit të mëher-shëm. Banka po vlerëson ndikimin potencial në pasqyrat e saj financiare nga aplikimi i SNRF 15.

Standardet e reja apo të ndryshuara si më poshtë nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës:

Në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016

SNRF 14 Llogaritë e Shtyra për arsye Rregullatore Kontabiliteti për Blerjet Interesave në Operacionet e Përbashkëta (Ndryshimet në SNRF 11)
Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit (Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38) Bujqësi: Bimët Prodhuese (Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 41) Metoda e Kapitalit neto në Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshimet në SNK 27) Përmirësimet vjetore në SNRF-të 2012-2014 – standarde të ndryshme

Njësitë Investuese: Zbatimi i Përrjashtimit për Konsolidimin (Ndryshimet në SNRF 10, 12 dhe SNK 28) Iniciativa për dhënien e informacioneve shpjeguese (Ndryshimet në SNK 1) Në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017 Iniciativa për dhënien e informacioneve shpjeguese (Ndryshime në SNK 7) Njohja e Aktiveve Tatimore të Shtyra për Humbjet e Përealizuara (Ndryshimet në SNK 12) Në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 SNRF 16 Qiratë.

4. Gjykimet kritike kontabël dhe burimet kyçe të pasigurisë së përlllogaritjes

Banka bën përlllogaritje dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Përlllogaritjet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe bazuar në përvojën historike dhe faktorët e tjerë, përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në kuadër të rrethanave.

(a) Supozimet dhe vlerësimet e pasigurive

Informacioni rreth supozimeve dhe vlerësimeve të pasigurive që kanë një risk të rëndësishëm pasi mund të çojnë në rregullime materiale në vitet pasardhëse është treguar më poshtë në lidhje me

zhvlerësimin e instrumentave financiar dhe në shënimin 6 - përcaktimi i vlerës së drejtë të instrumentave financiarë.

(i) Ngarkesa e zhvlerësimit për humbjet e kredisë

Banka rishikon portofolin e saj të kredive për të vlerësuar zhvlerësimet së paku në baza tremujore. Gjatë përcaktimit të asaj nëse humbja e zhvlerësimit duhet të regjistrohet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes, Banka gjykon nëse ka të dhëna të vëzhgueshme të cilat tregojnë se ka rënie të matshme në rrjedhat e përafërta të ardhshme të parasë së gatshme nga portofoli i kredive para se rënia të mund të identifikohet me një kredi individuale në atë portofol. Kjo dëshmi mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme duke treguar nëse ka pasur ndryshime të kundërta në statusin e pagesës së huadhënësve në një grup, ose kushtet kombëtare ose vendase ekonomike që ndërliken me mospagesën në aktive në grup.

Menaxhmenti bën përlllogaritjet bazuar në humbjen historike për aktivet me karakteristika rreziku të kredisë dhe dëshmi objektive të zhvlerësimit, të ngjashëm me ato në portofol gjatë programimit të rrjedhave të ardhshme të parasë së gatshme. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për përlllogaritjen e shumës dhe kohës së rrjedhave të ardhshme të parasë së gatshme janë rishikuar në mënyrë të rregullt për të reduktuar dallimet ndërmjet përlllogaritjeve të humbjes dhe përvojës së humbjes aktuale.

(ii) Zhvlerësimi i investimeve të vlefshme për shitje

Banka përcakton që investimet e vlefshme për shitje zhvlerësohen kur ka një rënie të madhe ose të zgjatur të vlerës së drejtë nën koston e saj. Përcaktim se çfare është e rëndësishme ose e zgjatur kërkon gjykim. Gjatë gjyimit, banka vlerëson ndërmjet faktorëve të tjerëve, paqëndrueshmërinë normale në çmimin e aksionit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm kur ka dëshmi të përkeqësimit në gjendjen financiare të investuesit, industrisë dhe performancës së sektorit, ndryshimeve në teknologji, dhe në rrjedhat operative dhe financuese të parave të gatshme.

Nëse të gjitha rëniet e vlerës së drejtë nën kosto do konsideroheshin si të rëndësishme ose të zgjatura, Banka do të kishte edhe 6 mijë EUR (2014: 64 mijë EUR) humbje shtesë në pasqyrat e saj financiare

të vitit 2015 duke përbërë totalin e transferimit të rezervës me vlerë totale të drejtë ndaj fitimit dhe humbjes. Shih shënimin 24.

(iii) Paqëndrueshmëria e fundit në tregjet globale financiare

Kriza financiare, e cila ka prekur pothuajse të gjitha shtetet evropiane, ka pasur një ndikim të kufizuar në Kosovë, në mënyrë primare falë shkallës së ulët të integritimit në tregjet globale të komoditeteve dhe atyre financiare. Rreziku kryesor për Kosovën manifestohet përmes një reduktimi të mundshëm në remitanca për shkak të rritjes së pritshme të ulët në Evropën Perëndimore

Bankat në Kosovë janë mirë të kapitalizuara dhe kanë proporcione të favorshme të kredive kundrejt depozitave. Gjithshtu, masat e ndërmarra nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) – në formë të kërkesave për bankat tregtare për të ushtruar politika të kujdesshme për të mbrojtur likuiditetin e mjaftueshëm dhe rezervat e kapitalit në rast të tendosjeve të jashtme – po ofrojnë sigurinë dhe stabilitetin e nevojshëm për sistemin.

ProCredit Bank sh.a është nga bankat e pakta në Kosovë që marrin pjesë direkt në tregjet financiare. Politikat e investimit për ProCredit Bank sh.a kanë mbetur konservative, që do të thotë se Banka investon likuiditetin e saj të tepërt vetëm në letrat me vlerë të cilësisë së lartë (shtetërore ose mbikombëtare të kategorizuara si AA- ose më lart). Për shkak të kësaj, Banka nuk është ndikuar dukshëm nga paqëndrueshmëritë në tregjet financiare në vitet e fundit, megjithëse investimet në letrat me vlerë me cilësi të lartë gjatë vitit 2015, sollën norma të ulëta apo edhe negative.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e Bankës e ekspozojnë atë ndaj një numri rreziqesh dhe këto aktivitetet përfshijnë analiza, vlerësim, pranueshmëri dhe menaxhim të një shkalle të rrezikut ose kombinimit të rreziqeve. Pranimi i rrezikut është thelbësor për biznesin financiar, dhe rreziqet operative janë një pasojë e pashmangshme e të qenit në biznes. Prandaj, synimi i Bankës është arritja e një ekuilibri të përshtatshëm ndërmjet rrezikut dhe kthimit si dhe minimizimi i efekteve negative të mundshme në performancën financiare të Bankës.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar këto rreziqe, për të përcaktuar limitet dhe kontrollet e rrezikut, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve përmes sistemeve të besueshme dhe të përditësuara informative. Banka në mënyrë të rregullt rishikon politikat e saj të menaxhimit të rrezikut dhe sistemet për të reflektuar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktika më të mira të reja.

Menaxhimi i rrezikut kryhet në mënyrë primare nga departamenti i rrezikut dhe departamenti i menaxhimit të rrezikut në Bankë i cili punon në kuadër të politikave të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve. Bordi ofron parime të shkruara për menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut, si dhe politika të shkruara që mbulojnë fushat specifike, siç janë, rreziqet kreditore, rreziku i shkëmbimit të monedhave të huaja, rreziku i normës së interesit dhe rreziku i likuiditetit. Gjithashtu, auditimi i brendshëm është përgjegjës për rishikim të pavarur të menaxhimit të rrezikut dhe mjedisit të kontrollit.

(a) Rreziku i kredisë

Banka ka ekspozim ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rreziku që pala e tretë do të shkaktojë një humbje financiare për Bankën duke dështuar të përmbushë një detyrim. Rreziku i kredisë është rreziku më i rëndësishëm për biznesin e Bankës; prandaj menaxhmenti përcakton me kujdes ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë. Ekspozimet e kredisë rrjedhin kryesisht nga aktivitetet e huazimit që sjellin kredi dhe pagesa në paradhënie, si dhe nga aktivitetet në investime që sjellin vendosjet dhe letrat me vlerë të borxhit në portofolin e Aktiveve të Bankës.

Ka gjithashtu rrezik të kredisë nga instrumentet financiare jashtë bilancit, siç janë letrat e kredive, garancitë dhe zotimet e kredive. Menaxhimi i rrezikut të kredisë dhe kontrolli për kredi dhe pagesa në paradhënie është i përqendruar në departamentin e menaxhimit të rrezikut të kredisë, ndersa rreziku ndërmjet bankave për vendosje dhe letra me vlerë të borxhit janë koncentruar në Departamentet e The-sarit dhe Menaxhimit të Rrezikut. Të gjitha departamentet përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe kontrollet, raportojnë në mënyrë të rregullt në Bordin e Menaxhimit dhe Bordin e Drejtorëve.

(i) Analiza e cilësisë së kredisë

Tabela më poshtë përcakton informacione mbi cilësinë e kredisë të aktiveve financiare dhe fondet për dëmtimet/ humbjet nga rënia në vlerë, mbajtur nga Banka kundrejt këtyre aktiveve.

Tabela më poshtë paraqet rastin më të keq të ekspozimit ndaj riskut të kredisë për Bankën më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, pa marrë në konsideratë kolaterale të mbajtur ose mbrojtje të tjera, të bashkëngjitura kredive. Për aktivet financiare, ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerën e mbartur ashtu si është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Saldo me Bankat Qendrore dhe Bonot e Thesarit likuide		Kredi dhe paradhënie për bankat		Kredi dhe paradhënie për klientët		Aktivet financiare të vlefshme për shitje		Aktive të tjera financiare		Angazhimet kreditore dhe garancitë	
	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014
Ekspozimi maksimal ndaj												
rrezikut të kredisë												
Vlera e mbartur	79,872	114,101	81,861	110,434	436,730	415,512	88,012	94,995	1,941	2,716	-	-
Shuma e angazhuar/ garantuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	85,601	73,638
	79,872	114,101	81,861	110,434	436,730	415,512	88,012	94,995	1,941	2,716	85,601	73,638
Me kosto të amortizuar												
Pa vonesa dhe zhvlerësime	79,872	114,101	81,861	110,434	419,401	387,189	88,012	94,995	1,941	2,716	-	-
Me vonesa por të pazhvlërësuar	-	-	-	-	13,383	15,301	-	-	-	-	-	-
Të zhvlërësuar	-	-	-	-	29,786	44,336	-	-	-	-	-	-
Shuma totale	79,872	114,101	81,861	110,434	462,570	446,826	88,012	94,995	1,941	2,716	-	-
Fonde për zhvlerësim												
(individuale dhe kolektive)	-	-	-	-	(25,840)	(31,314)	-	-	-	-	-	-
Vlera e mbartur neto	79,872	114,101	81,861	110,434	436,730	415,512	88,012	94,995	1,941	2,716	-	-
Jashtë bilancit të gjendjes:												
ekspozimi maksimal												
Angazhimet kredituese:												
rrezik i ulët - i pranueshëm	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	55,956	47,030
Garanci financiare:												
rrezik i ulët - i pranueshëm	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	28,094	26,309
Letra kredie:												
rrezik rrezik i ulët - i pranueshëm	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,551	299
Angazhimet totale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	85,601	73,638
Provizionet e njohura si detyrim-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	(278)	(323)
Ekspozimi total	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	85,323	73,315

	2015			2014		
	Individë	Korporata	Totali	Individë	Korporata	Totali
Kreditë dhe paradhëniet për klientët						
Shuma totale	129,972	332,598	462,570	134,092	312,734	446,826
Fonde për zhvlerësim (individuale dhe kolektive)	(5,751)	(20,089)	(25,840)	(3,880)	(27,434)	(31,314)
Vlera e mbartur neto	124,221	312,509	436,730	130,212	285,300	415,512
Me kosto të amortizuar						
Pa vonesa dhe zhvlerësime	122,770	296,631	419,401	130,101	257,088	387,189
Me vonesa por të pazhvlërësuar	4,613	8,770	13,383	2,527	12,774	15,301
Të zhvlërësuar	2,589	27,197	29,786	1,464	42,872	44,336
Shuma totale	129,972	332,598	462,570	134,092	312,734	446,826
Fonde për zhvlerësim (individuale dhe kolektive)	(5,751)	(20,089)	(25,840)	(3,880)	(27,434)	(31,314)
Vlera e mbartur neto	124,221	312,509	436,730	130,212	285,300	415,512
Kreditë me kushte të rinegociuara						
Vlera e mbartur	1,550	43,428	44,978	1,835	53,917	55,752
Nga të cilat: Zhvlerësuar	359	21,668	22,027	288	33,731	34,019
Fonde për zhvlerësim	(453)	(10,127)	(10,580)	(427)	(17,381)	(17,808)
Vlera e mbartur neto	1,097	33,301	34,398	1,408	36,536	37,944
Me vonesa por të pazhvlërësuar						
Me vonesa 0 - 30 ditë	2,607	6,009	8,616	1,499	9,196	10,695
Me vonesa 31 - 90 ditë	1,116	1,540	2,656	536	1,887	2,423
Me vonesa 91 - 180 ditë	890	1,221	2,111	492	1,691	2,183
	4,613	8,770	13,383	2,527	12,774	15,301
Të zhvlërësuar						
Me vonesa 0 - 30 ditë	447	16,190	16,637	370	24,068	24,438
Me vonesa 31 - 90 ditë	157	742	899	-	1,025	1,025
Me vonesa 91 - 180 ditë	65	1,895	1,960	-	929	929
Me vonesa mbi 180 ditë	1,920	8,370	10,290	1,094	16,850	17,944
	2,589	27,197	29,786	1,464	42,872	44,336
Fonde për zhvlerësim						
Individuale	(605)	(12,200)	(12,805)	(456)	(20,552)	(21,008)
Kolektive	(5,146)	(7,889)	(13,035)	(3,424)	(6,882)	(10,306)
Totali i fondeve për zhvlerësim	(5,751)	(20,089)	(25,840)	(3,880)	(27,434)	(31,314)

Zhvlërësimet dhe provizionet

Provizionet e rënies së vlerës (zhvlërësimet) regjistrohen për qëllime të raportimit financiar vetëm për humbjet që janë shkaktuar në ditën e raportimit bazuar në dëshminë objektive të zhvlërësimit (shihni shënimin 3.(f)(vii)).

Politika e Bankës kërkon rishikimin e aktiveve individuale financiare që janë mbi pragjet e materialitetit të paktën një herë në vit ose në mënyrë më të rregullt kur kjo kërkohet nga rrethanat. Lejimet ose fondet e zhvlërësimeve në llogaritë e vlerësuar në baza individuale janë përcaktuar përmes vlerësimit të humbjes së shkaktuar në datën e raportimit rast për rast dhe aplikohen për të gjitha llogaritë e rëndësishme individuale. Vlerësimi zakonisht përfshin kolateralin e mbajtur (përfshirë rikonfirmimin e ekzekutimit të tij) dhe pranimet e pritura për atë llogari individuale. Vlerësimi kolektiv i zhvlërësimit të një grupi të aktiveve financiare bazohet në analizën kuantitative të normave të mospagesës historike për portofolin e kredisë me karakteristika të ngjashme. Normat kuantitative të mospagesës të llogaritura në këtë mënyrë i janë nënshtruar një analize kualitative (analizë migrimi).

Sipas metodologjisë së brendshme Banka përcakton zhvlërësimin e kredive të humbura në përputhje me alokimin e ekspozimit të kredisë në tre kategori të ndryshme si më poshtë:

- Zhvlërësime individuale specifike,
- Provizionet e bazuara në portofol,
- Provizionet specifike me një shumë.

Zhvlërësime individuale specifike: në këtë kategori, Banka njeh provizionin për të gjitha ekspozimet e rëndësishme kreditore individuale që janë zhvlërësuar bazuar në numrin e ditëve të vonesës (d.m.th. më shumë se 30 ditë vonesë).

Provizionet e bazuara në portofol: në këtë kategori, Banka provizionon të gjitha ekspozimet e kredive (individualisht të rëndësishme dhe individualisht jo të rëndësishme) që nuk tregojnë shenja objektive zhvlërësimi.

Provizionet specifike me një shumë: provizionet e humbjes së kredive janë përcaktuar për ekspozimet individuale jo të rëndësishme kreditore që janë zhvlërësuar bazuar në numrin e ditëve të vonesave (d.m.th. më shumë se 30 ditë vonesë).

Politika e Bankës kërkon rishikimin e ekspozimeve kreditore individuale së paku në baza tremujore kur kjo kërkohet nga rrethanat individuale. Lejimet e zhvlërësimeve në ekspozimet kreditore e vlerësuar në mënyrë individuale janë përcaktuar përmes vlerësimit të humbjes së shkaktuar në datën e raportimit rast për rast dhe aplikohen për ekspozimet kreditore individuale të rëndësishme. Vlerësimet zakonisht përfshijnë kolaterale të mbajtura (përfshirë konfirmimin e ekzekutueshmërisë së tyre) dhe flukset e pritshme nga ekspozimet kreditore.

Kredi me vonesë por të pazhvlërësuar

Kredive të cilave u ka kaluar afati, por nuk janë zhvlërësuar janë ato kredi, ku interesit kontraktual ose pagesave të principalit ju ka kaluar afati, por Banka beson se zhvlërësimi nuk është i përshtatshëm në baze të nivelit të sigurisë / kolateralit të disponueshëm dhe / apo në stadin e mbledhjes së shumave që i detyrohen Bankës.

Kreditë me kushte të rinegociuara

Kredi me kushte të rinegociuara janë kreditë të cilat janë ristrukturuar si dhe cdo ndryshim i termave dhe kushteve të kontratës së një ekspozimi kreditor ndërmjet Bankës dhe klientit për të ndryshuar planin e pagesave të ekspozimit kreditor në përgjigje të një rritjeje të tanishme apo të ardhshme të rrezikut kreditor të paracaktuar i cili rrezik është i lidhur me klientin. Një vendim për të ristrukturuar i nënshtrohet kushteve në vijim:

- Ristrukturimi rrit mundësinë që huamarrësi do të jetë në gjendje të paguajë ekspozimin ndaj kredisë
- Ristrukturimi e rrit mundësinë që Banka do ta rimarrë borxhin e mbetur më shpejt me një masë më të madhe/ ose me kosto më të ulët e cila mund të arrihet përmes një procesi ligjor të rikthimit.
- Plani i ri i pagesave është në përputhje me kapacitetin e tanishëm dhe të ardhshëm të huamarrësit
- Huamarrësi ofron kolateral shtesë, nëse është e mundur dhe e përshtatshme.

Duke u bazuar tek lloji i ristrukturimit (standarde ose të zhvlërësuar), ekspozimi i kredisë mund të kategorizohet ose jo në një kategori më të mirë bazuar në performancën e ekspozimit. Kreditë e zhvlërësuar të ristrukturuara qëndrojnë në të njëjtën kategori, pavarësisht nga performanca pas ristrukturimit.

Politika e fshirjes

Banka fshin një kredi (dhe çdo fond për humbjet prej saj) kur është përcaktuar që kjo kredi është e pambledhshme. Ky përcaktim arrihet pasi merret në konsideratë informacioni për gjendjen financiare të huamarrësit i cili nuk mund të paguajë detyrimin e tij, ose kur të ardhurat nga shitja e kolateralit nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Sa më të vogla shumat e mbetura, sa më i madh numri i ditëve me vonesë, dhe sa më të mëdha janë paqartësitë rreth përmirësimit (të tilla si kushte ligjore të paparashikueshme), aq më të vogla do të jenë mundësitë e mbledhjes së borxhit nga Banka.

Te drejta ndaj bankave

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga menaxhimi i rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare me bankat lokale në gjendje të shëndetshme apo ndërkombëtare. Para se një marrëdhënie biznesi me një bankë të caktuar të nisë, Departamenti i rrezikut dhe menaxhimi kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve, monitorohen vazhdimisht për renditjen e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor's (S & P), Fitch dhe Moody's.

Një funksion i pavarur nga departamenti i thesarit, zakonisht menaxhimi i riskut, duhet të monitorojë se ekspozimi ndaj të gjitha bankave nuk i kalon limitet rregullatore ose limitet e brendshme të vendosura nga menaxhmenti i Bankës. Kështu, menaxhimi i riskut mbështet Departamentin e Thesarit, duke siguruar raporte ditore që tregojnë ekspozimet dhe depozitat që mund të bëhen për të gjitha bankat korrespondente pa shkelur kufijtë aktualë të ekspozimit. Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk do të kenë asnjë ekspozim total të rrezikut të kredisë ndaj palëve të lidhura që tejkalon 15% të Nivelit I të kapitalit rregullator. Përveç kësaj, për të reduktuar më tej rrezikun e palës korresponduese, ALCO miraton kufizime të brendshme për ekspozimet ndaj palës korresponduese pak më ulët se kërkesat rregullatore, kufij të cilët janë respektuar vazhdimisht nga Banka.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat janë dhënë pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse të bankave dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas rankimit kreditor:

Me 31 dhjetor	2015	2014
AA+ deri AA-	34,859	9,938
A+ deri A-	22,960	87,532
BBB+ deri B-	24,042	12,964
	81,861	110,434

Aktivet financiare të vlefshme për shitje

Investimet në letrat me vlerë të borxhit janë me qeveri, bankat qendrore dhe huamarrës të tjerë mbi-kombëtarë të vlerësuar si AA- ose më lart nga Fitch, S & P ose Moody. Ekspozimi ndaj instrumenteve të borxhit është i rregulluar me anë të Politikave të Investimeve.

Investimet janë të lejuara vetëm në letrat me vlerë likuide që kanë vlerësim të lartë. Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë është përfaqësuar nga vlera kontabël neto e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Tabela më poshtë paraqet të gjithë portofolin, i cili përfshin letrat me vlerë jo të rankuara të Qeverisë së Kosovës:

Rankimet më 31 Dhjetor	2015	2014
AAA	56,227	72,479
AA+	7,426	9,134
Jo të rankuara	24,359	13,382
Totali	88,012	94,995

Angazhimet e kreditimit dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka duhet të paguajë nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe se shumata e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për angazhimet e kreditimit është shumata plotë e angazhimit (Shënimi 26).

(ii) Kontrolli i kufirit të rrezikut dhe politikat reduktuese

Banka menaxhon kufijtë dhe kontrollon përqendrimit e rrezikut të kredisë, kudo që keto janë identifikuar, në mënyrë të veçantë me palë individuale dhe grupe dhe palë të lidhura.

Banka strukturon nivelet e riskut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës, ose grup huamarrës, dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Rreziqet e tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme. Kufijtë në nivelin e rrezikut të kredisë sipas produktit, rajonit dhe sektorit të industrisë, janë aprovuar nga Bordi Drejtues.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditimit manaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përbushur shlyerjen e detyrimeve të interesit dhe të kapitalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Kontrollat e tjera dhe masat reduktuese janë përshkruar më poshtë. Kolaterali i mbajtur dhe përmirësime kreditore të tjera dhe efekti i tyre financiar

Banka përdor një numër politikash dhe praktikash për të ulur rrezikun e kredisë, ku më e zakonshme është marrja e sigurisë dhe kolateraleve për fondet e dhena. Banka zbaton udhëzime mbi pranueshmërinë e llojeve specifike të kolateralit si dhe uljen e rrezikut të kredisë. Llojet kryesore të kolateralit

për kreditë dhe paradhëniet janë:

- Hipoteka mbi pronat e banimit
- Pengu mbi aktivet e biznesit të tilla si ndërtesa, pajisje dhe inventare
- Pengu mbi para dhe ekuivalentet e mjeteve monetare (kolateral me mjete monetare)

Kreditë për korporatat dhe individët janë në përgjithësi të siguruara; overdrafte (mbitërheqje) private individuale dhe kartat e kreditit të lëshuara për individët janë të siguruara me para të gatshme ose lloje të tjera të kolateralit të përcaktuara me vendim të komiteteve të kreditit. Përveç kësaj, për të minimizuar humbjen e kredisë Banka do të kërkojë kolateral shtesë nga pala sapo vihen re tregues zhvlerësimi për kreditë dhe paradhëniet përkatëse individuale.

Efekti financiar i kolateralit është paraqitur duke shpalosur vlerat e kolateraleve veçmas për (i) ato aktive ku kolaterali dhe përmirësimet e sigurite e tjera janë të barabarta ose kalojnë vlerën e mbetur të aktiveve ('aktivet e mbikolateralizuara'), dhe (ii) ato aktive ku kolaterali dhe përmirësimet e sigurite e tjera më pak se vlerë e mbetur e aktiveve ('aktivet e nenkolateralizuara').

(ii) Kontrolli i kufirit të rrezikut dhe politikat reduktuese (vazhdim)

	2015			2014
	Vlera kontabël e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera kontabël e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit
Më 31 Dhjetor				
Individet				
Overdrafte	2,340	234	3,249	150
Karta krediti	707	229	831	855
Kreditë konsumatore	7,576	5,267	6,002	3,470
Përmirësimi i shtëpive	113,597	125,927	120,130	118,518
Korporata				
Overdrafte biznesi	43,288	134,645	35,909	134,461
Biznes deri në 150 mijë Euro	153,651	237,478	153,451	257,776
Biznes mbi 150 mijë Euro	115,571	181,567	95,940	188,532
	436,730	685,347	415,512	703,762

Vlera e drejtë e kolateralit vlerësohet nga Banka në baza individuale për cdo huadhënie. Ne përgjithësi vlerat e vlerësuara janë përcaktuar me reference në vlerat e tregut. Të hyrat e pritshme nga likuidimi i kolateralit janë marrë gjithashtu në konsideratë në

llogaritjen e provizionit/zhvlerësimit individual.

Më poshtë është një analizë e kolateralit të kredisë dhe sigurive marrë përgjatë viteve

	Kredi dhe paradhënie për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Individë	Korporata	Totali	Individë	Korporata	Totali
31 Dhjetor 2015						
Hipoteka	21,692	216,315	238,007	68,511	298,413	366,924
Pengje	97,859	95,881	193,740	63,146	255,277	318,423
Ekspozime të pasiguruara	4,670	313	4,983	-	-	-
Totali	124,221	312,509	436,730	131,657	553,690	685,347

	Kredi dhe paradhënie për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Individë	Korporata	Totali	Individë	Korporata	Totali
31 Dhjetor 2014						
Hipoteka	19,159	187,919	207,078	60,131	291,273	351,404
Pengje	102,403	96,859	199,262	62,862	289,496	352,358
Ekspozime të pasiguruara	8,650	522	9,172	-	-	-
Totali	130,212	285,300	415,512	122,993	580,769	703,762

(iii) Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Përqendrimet lindin kur një numër i palëve të tjera janë të angazhuara në aktivitete të ngjashme të biznesit, apo veprimtari në të njëjtin rajon gjeografik, ose kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të shkaktojnë ndikime të ngjashme në aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale si rrjedhojë e ndryshimeve në kushtet ekonomike, politike apo të tjera. Përqendrimet tregojnë ndjeshmërinë relative të performancës së Bankës ndaj zh-

villimeve që ndikojnë në një industri të veçantë ose zonë gjeografike.

1) Sektorët gjeografikë

Tabela e mëposhtme ndan ekspozimin kryesor të kredisë së Bankës në shumat bruto sic janë kategorizuar sipas rajonit gjeografik më 31 dhjetor 2015 dhe 2014. Banka ka alokuar ekspozimet sipas rajoneve bazuar në vendin e qendrimit të palëve të treta.

	2015			2014		
	Shtetet e OECD	Kosova	Totali	Shtetet e OECD	Kosova	Totali
Saldot me Bankën Qendrore	2,398	77,474	79,872	1,989	112,112	114,101
Kredi dhe avanca për bankat	81,861	-	81,861	110,434	-	110,434
Kredi dhe avanca për klientët	-	436,730	436,730	-	415,512	415,512
Aktivitet financiarë të vlefshme për shitje	63,712	24,300	88,012	81,637	13,358	94,995
Aktive të tjera financiare	-	1,941	1,941	-	2,716	2,716
	147,971	540,445	688,416	194,060	543,698	737,758

	2015			2015		
	Shtetet e OECD	Kosova	Totali	Shtetet e OECD	Kosova	Totali
Saldot me Bankën Qendrore	-	79,872	79,872	-	114,101	114,101
Kredi dhe avanca për bankat	-	81,861	81,861	-	110,434	110,434
Kredi dhe avanca për klientët	124,221	312,509	436,730	130,212	285,300	415,512
Aktivitet financiarë të vlefshme për shitje	-	88,012	88,012	-	94,995	94,995
Aktive të tjera financiare	-	1,941	1,941	-	2,716	2,716
	124,221	564,195	688,416	130,212	607,546	737,758

(b) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e ekuitetit, kurset e këmbimit të monedhës së huaj dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në pozitën kreditore të emetuesit / obligatorit), do të ndikojë në të ardhurat e Bankës ose vlerën e investimve në instrumentet financiare të saj. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

(i) Rreziku i valutës së huaj

Rreziku i valutës është rreziku që vlera e instrumentit financiar do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në normat e këmbimit të valutës së huaj. Banka nuk synon të fitojë nga ndonjë transaksion spekulativ, por mundohet të mbajë pozitën e saj të hapur afër zeros gjatë gjithë kohës. Limitet e pozitës së hapur valutore dhe kapaciteti i pranimit

të rrezikut për Bankën janë përcaktuar sipas politikave përkatëse, të cilat janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, dhe rishikuar në baza javore nga departamenti i menaxhimit të rrezikut. Përveç kësaj, limitet rregullative janë zbatuar gjatë tërë kohës nga ana e Bankës.

Normat zyrtare për monedhat kryesore të përdorura në kthimin e zërave në valutë të huaj janë si më poshtë (në EUR):

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
1 USD	0.9185	0.8237
1 CHF	0.9229	0.8317
1 GBP	1.3625	1.2839

Tabelat në vijim përmbledhin aktivet dhe detyrimet e Bankës në valutat e huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, të kthyera në mijë EUR.

31 Dhjetor 2015	EUR	USD	CHF	GBP	Total
Aktivet					
Paraja dhe saldot me Bankën Qendrore	161,516	1,114	1,895	283	164,808
Kredi dhe avanca për bankat	67,269	13,794	677	121	81,861
Kredi dhe avanca për klientët	434,282	2,448	-	-	436,730
Aktivet financiare të vlefshme për shitje	80,586	7,426	-	-	88,012
Aktive të tjera financiare	1,367	574	-	-	1,941
Totali	745,020	25,356	2,572	404	773,352
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave	248	-	1	-	249
Detyrime ndaj klientëve	649,550	25,453	2,647	407	678,057
Hua dhe detyrime të varura	15,668	-	-	-	15,668
Detyrime të tjera financiare	1,267	-	-	-	1,267
Totali	666,733	25,453	2,648	407	695,241
Pozita neto e bilancit te gjendjes	78,287	(97)	(76)	(3)	78,111
Zotimet e kredisë	55,786	160	-	-	55,946
Letrat e kredisë	1,551	-	-	-	1,551
Garancitë bankare	27,865	229	-	-	28,094
Zotimet totale të lidhura me kredi	85,202	389	-	-	85,591
31 Dhjetor 2014					
Aktivet					
Paraja dhe saldot me Bankën Qendrore	156,298	1,466	3,691	596	162,051
Kredi dhe avanca për bankat	100,149	6,547	3,597	141	110,434
Kredi dhe avanca për klientët	413,294	2,218	-	-	415,512
Aktivet financiare të vlefshme për shitje	82,626	12,369	-	-	94,995
Aktive të tjera financiare	2,201	515	-	-	2,716
Totali	754,568	23,115	7,288	737	785,708
Detyrimet					
Detyrime ndaj bankave	281	-	1	-	282
Detyrime ndaj klientëve	655,079	23,186	7,191	755	686,211
Hua dhe detyrime të varura	14,825	-	-	-	14,825
Detyrime të tjera financiare	1,107	-	-	-	1,107
Totali	671,292	23,186	7,192	755	702,425
Pozita neto e bilancit te gjendjes	83,276	(71)	96	(18)	83,283
Zotimet e kredisë	46,949	81	-	-	47,030
Letrat e kredisë	181	118	-	-	299
Garancitë bankare	25,698	611	-	-	26,309
Zotimet totale lidhur me kredi	72,828	810	-	-	73,638

Tabela më poshtë përmbledh analizën e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të valutës së huaj dhe efektin mbi fitimin dhe humbjen:

	Rritja 2015	Rritja 2014	Efekti mbi fitimin dhe humbjen	
			31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
USD	10%	10%	11	9
Të tjera	10%	10%	8	13

(ii) Rreziku i normës së interesit

Banka ekspozohet ndaj rreziqeve të ndryshme që shoqërojnë efektet e luhatjeve të normave të interesit të tregut në pozitën e saj financiare dhe në rrjedhat e parasë së gatshme. Banka ProCredit nuk synon të bëjë fitime përmes transformimit të tepruar maturitetit, ose formave të tjera të spekulimit në tregun e normës së interesit. Në vend të kësaj, Banka kërkon të sigurojë që struktura e aktiveve dhe pasiveve është balancuar përgjatë të gjitha maturiteteve.

Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit të Bankës është në pajtim me Bazel II. Ai merr parasysh si te ndjeshme ndaj normës së interesit vetëm kryegjënë (vlerën emërore); ndryshimet në interesin e përlogaritur dhe ndryshimet në vlerën reale janë konsideruar si jo të ndjeshme ndaj normës të interesit.

Tabelat më poshtë përmbledhin ekspozimin e Bankës ndaj rreziqeve të normës së interesit. Të përfshira në tabela janë aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës, me interesa fikse dhe jofikse.

Hendeku i ndjeshmërisë së interes në EUR		Deri në	1-3	3-6	6-12	1-2 vjet	2-5 vjet	Më	Ndjesh-	Pa
Më 31 dhjetor 2015		1 muaj	muaj	muaj	muaj			shumë	mëria	ndjesh-
								se 5 vjet	totale e	mëri ndaj
									interesis	interesis
Aktivët										
Para të gatshme		-	-	-	-	-	-	-	-	83,822
Saldot me Banka Qendrore		250	-	-	-	-	-	-	250	79,622
Llogaritë rrjedhëse me bankat		16,681	-	-	-	-	-	-	16,681	2,539
Bonot e thesarit dhe letrat										
me vlerë të tregtueshme	Fiks	2,000	3,860	9,840	21,000	23,100	550	-	60,350	2,070
	Variabël	-	18,000	-	-	-	-	-	18,000	166
Depozitatat me afat me bankat		20,900	27,950	-	-	-	-	-	48,850	(3)
Kreditë dhe paradhëniet										
për klientët	Fiks	23,339	35,088	54,941	106,230	99,471	118,420	16,230	453,719	(23,319)
	Variabël	3,935	-	-	-	-	-	-	3,935	
Aktive të tjera		-	-	-	-	-	-	-	-	19,709
Totali i aktiveve		67,105	84,898	64,781	127,230	122,571	118,970	16,230	601,785	164,606
Detyrimet										
Llogari rrjedhëse të bankave		-	-	-	-	-	-	-	-	249
Llogari rrjedhëse të klientëve		30,074	8,020	12,030	24,059	48,118	78,192	-	200,493	351,038
Depozita nga klientët		9,515	11,350	15,076	38,865	12,064	9,894	491	97,255	3,818
Hua dhe detyrime të varura	Fiks	-	-	-	-	-	-	8,000	8,000	21
	Variabël	-	7,500	-	-	-	-	-	7,500	147
Detyrime të tjera dhe kapitali -		-	-	-	-	-	-	-	-	97,870
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		39,589	26,870	27,106	62,924	60,182	88,086	8,491	313,248	453,143
Hendeku i ndjeshmërisë së normës së interesit- pozicioni i hapur										
		27,516	58,028	37,675	64,306	62,389	30,884	7,739	288,537	(288,537)

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në EUR Më 31 dhjetor 2014	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Ndjesh- mëria totale e interesit	Pa ndjesh- mëri ndaj interesit
Aktivët									
Para të gatshme	-	-	-	-	-	-	-	-	46,484
Saldot me Banka Qendrore	300	-	-	-	-	-	-	300	113,801
Llogaritë rrjedhëse me bankat	43,134	-	-	-	-	-	-	43,134	851
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	Fiks 19,250	11,800	17,100	29,250	4,000	-	-	81,400	1,225
Depozitat me afat me bankat	7,000	32,900	20,000	-	-	-	-	59,900	2
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fiks 16,237	34,827	53,318	97,444	96,725	113,189	16,946	428,686	(19,075)
	Variabël 3,683	-	-	-	-	-	-	3,683	-
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	18,221
Totali i aktiveve	89,604	79,527	90,418	126,694	100,725	113,189	16,946	617,103	161,509
Detyrimet									
Llogari rrjedhëse të bankave	-	-	-	-	-	-	-	-	282
Llogari rrjedhëse të klientëve	40,212	8,030	12,046	24,091	48,182	68,257	-	200,818	300,615
Depozita nga klientët	21,565	21,586	25,255	59,644	16,831	14,382	996	160,259	1,332
Hua dhe detyrime të varura	Fiks -	-	-	-	-	-	-	-	-
	Variabël -	14,545	-	-	-	-	-	14,545	280
Detyrime të tjera dhe kapitali	-	-	-	-	-	-	-	-	100,481
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	61,777	44,161	37,301	83,735	65,013	82,639	996	375,622	402,990
Hendeku i ndjeshmërisë të normës së interesit- pozicioni i hapur									
	27,827	35,366	53,117	42,959	35,712	30,550	15,950	241,481	(241,481)

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në EUR	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Ndjeshmëria totale e interesit	Pa ndjeshmëri ndaj interesit
Më 31 dhjetor 2015								
Para të gatshme	-	-	-	-	-	-	-	1,114
Llogaritë rrjedhëse me bankat	6,138	-	-	-	-	-	6,138	755
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	Fiks -	7,348	-	-	-	-	7,348	78
Depozitatat me afat me bankat	2,296	4,593	-	-	-	-	6,889	12
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Fiks 10	1,331	582	158	144	273	2,498	(103)
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	-	673
Totali i aktiveve	8,444	13,272	582	158	144	273	22,873	2,529
Llogaritë rrjedhëse me klientët	1,335	357	534	1,068	2,137	3,472	8,903	16,305
Depozita nga klientët	2	18	82	142	-	-	244	1
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-	-	(51)
Totali i detyrimeve	1,337	375	616	1,210	2,137	3,472	9,147	16,255
Hendeku i ndjeshmërisë së normës së interesit- pozicioni i hapur	7,107	12,897	(34)	(1,052)	(1,993)	(3,199)	13,726	(13,726)
Më 31 Dhjetor 2014								
Para të gatshme	-	-	-	-	-	-	-	1,466
Saldot me Banka Qendrore	2,992	-	-	-	-	-	2,992	260
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme	Fiks -	12,355	-	-	-	-	12,355	15
Depozitatat me afat me bankat	-	3,295	-	-	-	-	3,295	-
Kreditë dhe paradhënie për klientët	Fiks 5	1,371	263	129	115	374	2,257	(39)
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	-	540
Totali i aktiveve	2,997	17,021	263	129	115	374	20,899	2,242
Llogaritë rrjedhëse me klientët	1,786	357	536	1,072	2,143	3,036	8,930	13,459
Depozita nga klientët	172	255	78	282	2	-	789	9
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-	-	(46)
Totali i detyrimeve dhe ekuiteti	1,958	612	614	1,354	2,145	3,036	9,719	13,422
Hendeku i ndjeshmërisë së normës së interesit- pozicioni i hapur	1,039	16,409	(351)	(1,225)	(2,030)	(2,662)	11,180	(11,180)

Analizat dhe përlogaritjet bëhen për të përcaktuar ndikimin nga lëvizjet e normave të interesit në vlerat ekonomike të kapitalit dhe kapacitetin për te fituar përgjatë një periudhe kohe, dhe si pasojë për të zvogëluar rreziqet me ndikime mbi këto dy parametra.

Duke marrë parasysh strukturat e aktiveve dhe detyrimeve në EUR dhe USD më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, dhe duke supozuar një zhvendosje paralele të normës së interesit për +/-200 pikë, në aktivet dhe detyrimet me ndjeshmeri ndaj normave, profili i rrezikut ndaj normës së interesit të Bankës paraqitet më poshtë, ku shifrat negative përfaqësojnë humbje:

Rritja e normës së interesit me 2%	Rënie e interesit të fituar gjatë 3 muajve në vazhdim		Rënie e interesit të fituar për një vit në vazhdim		Impakti i vlerës ekonomike	
	2015	2014	2015	2014	2015	2014
Aktivitet dhe detyrimet						
EUR	183	179	2,124	1,973	(6,129)	(5,796)
USD	51	32	346	283	167	137

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë më në gjendje, të përmbushë obligimet e saj të tanishme dhe të ardhshme në pagesa të plota apo në kohë. Prandaj Banka duhet të mbajë në të gjitha kohët fonde të mjaftueshme likuide, në dispozicion për të plotësuar obligimet e saj, madje edhe në kushte të rrethanave potenciale të jashtëzakonshme. Rreziku i likuiditetit është gjithashtu rreziku që financimi shtesë nuk mund të sigurohet më, ose mund të sigurohet vetëm me norma të rritura të interesit. Mund të shkaktohet nga pengesat në treg ose përkeqesimet e kredive të cilat mund të shkaktojnë që disa burime të caktuara të financimit të bëhen jo të disponueshme. Për të zbutur rrezikun e likuiditetit, Banka diversifikon burimet e financimit dhe menaxhon Aktivitet likuide me kujdes, duke mbajtur një bilanc të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të parasë së gatshme, që janë të mjaftueshme për të përmbushur menjëherë detyrimet e kërkuara.

Tabela më poshtë paraqet analizën e likuiditetit sipas maturiteteve të mbetura kontraktuale në datën e raportimit si dhe sipas maturiteteve të pritura të të dhënave financiare. Shumat e shpalosura në pjesën e parë të tabelës janë rrjedha të skontuara kontraktuale të parasë së gatshme; sidoqoftë, Banka menaxhon rrezikun e trashëguar të likuiditetit bazuar në të hyrat dhe të dalat e parasë së gatshme siç raportohet në pjesën e dytë. Në transformimin e detyrimeve nga ato të kontraktuara në të pritura, Banka konsideron dy paketa të supozimeve: supozimet të cilat janë rekomanduar nga ProCredit Holding dhe të cilat janë bazuar në Rregulloret Gjermane të Likuiditetit, dhe supozimet të cilat dalin nga analiza historike e depozitave të klientëve dhe modelet e tyre

të tërheqjes. Banka synon në të gjitha kohët për të mbajtur pozitiv hendekun kumulativ të maturitetit të pritur. Nëse hendeku i pritur i maturitetit kumulativ nuk do të jetë pozitiv, Banka e konsideron profilin e likuiditetit në një "pozitivë vëzhguese të likuiditetit".

Shifrat e raportuara me instrumentin raportues më poshtë nuk përkojnë me shifrat në pasqyrën e pozicionit financiar, dhe kjo për shkak të faktit se përveç pozitave të bilancit, Banka ka marrë parasysh pozitat jashtë bilancit gjithashtu. Të gjitha Aktivitet dhe detyrimet financiare janë raportuar bazuar në kohën kur detyrimet (përfshirë detyrimet kontingjente nga garantitë bankare, letrat e kredive dhe zotimet e tjera të lidhura me kreditë) bëhen të pagueshme dhe Aktivitet mund të përdoren si burime të pagesës (përfshirë zerat jashtë bilancit siç janë zotimet e kredive të patërhequra dhe të pakushtëzuara, të cilat Banka mund ti përdorë si burime likuiditeti në çfarëdo kohe pa aprovim paraprak).

Në tabelën e hendekut të likuiditetit më poshtë, përcaktimet në vijim janë konsideruar si të rëndësishme:

- Aktivitet 1 - janë Aktivitet të cilat nuk kanë maturitet kontraktual dhe/ose mund të konvertohen në para të gatshme shumë shpejt,
- Aktivitet 1-S – janë Aktivitet që kanë maturitet kontraktual dhe shpërndahen bazuar në maturitetet mbetëse,
- Detyrimet 1 – janë detyrimet të cilat në mënyrë kontraktuale janë detyrime me kërkesë,
- Detyrimet 1-S – janë detyrimet që kanë maturitet kontraktual dhe të cilat shpërndahen në periudha kohore bazuar në maturitetet e mbetura.

	Deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	> 1 vit	Totali
Aktivët 1						
Paraja e gatshme	84,936	-	-	-	-	84,936
Rezervat e detyrueshme me Bankën Qendrore	24,678	-	-	-	-	24,678
Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore	55,194	-	-	-	-	55,194
Llogaritë rrjedhëse me bankat	26,113	-	-	-	-	26,113
Zotimet e papërdorura të kredisë	17,000	-	-	-	-	17,000
Bono thesari dhe letrat me vlerë të tregtueshme	1,998	11,236	9,799	21,229	42,656	86,918
Aktivët 1-S						
Depozitat me afat me bankat	23,196	32,543	-	-	-	55,739
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	21,827	32,903	50,171	97,080	258,173	460,154
Aktivët totale	254,942	76,682	59,970	118,309	300,829	810,732
Detyrimet kontraktuale						
Detyrimët 1						
Detyrimet ndaj bankave (detyrimet ditore)	249	-	-	-	-	249
Detyrimet ndaj klienteve (detyrimet ditore)	570,130	-	-	-	-	570,130
Detyrimet kontingjente nga garancitë	29,645	-	-	-	-	29,645
Zotimet e papërdorura të kredisë	55,946	-	-	-	-	55,946
Detyrimët 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	9,438	12,116	15,823	39,809	26,922	104,108
Huamarrje dhe detyrime të varura	-	-	-	-	15,500	15,500
Detyrimet totale kontraktuale	665,408	12,116	15,823	39,809	42,422	775,578
Hendeku periodik kontraktual i likuiditetit	(410,466)	64,566	44,147	78,500	258,407	35,154
Hendeku kumulativ kontraktual i likuiditetit	(410,466)	(345,900)	(301,753)	(223,253)	35,154	
Detyrimet e pritura						
Detyrimët 1						
Detyrimet ndaj bankave (detyrimet ditore)	124	124	-	-	-	626
Detyrimet ndaj klienteve (detyrimet ditore)	85,780	23,031	34,172	68,344	358,804	570,130
Detyrimet kontingjente nga garancitë	1,482	-	-	-	-	1,482
Zotimet e papërdorura të kredisë	11,189	-	-	-	-	11,189
Detyrimët 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	9,438	12,116	15,823	39,809	26,922	104,108
Huamarrje dhe detyrime të varura	-	-	-	-	15,500	15,500
Detyrimet totale të pritura	108,013	35,271	49,995	108,153	401,226	702,435
Hendeku periodik i likuiditetit	146,929	41,410	9,975	10,156	(100,397)	108,073
Hendeku kumulativ i likuiditetit	146,929	188,339	198,314	208,470	108,073	

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	> 1 vit	Totali
Aktivët 1						
Paraja e gatshme	47,950	-	-	-	-	47,950
Rezervat e detyrueshme me Bankën Qendrore	42,767	-	-	-	-	42,767
Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore	71,334	-	-	-	-	71,334
Llogaritë rrjedhëse me bankat	47,237	-	-	-	-	47,237
Zotimet e papërdorura të kredisë	25,000	-	-	-	-	25,000
Bono thesari dhe letrat me vlerë të tregtueshme	19,260	24,165	17,164	29,590	4,005	94,184
Aktivët 1-S						
Depozitat me afat me bankat	7,000	36,197	20,000	-	-	63,197
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	25,385	32,785	51,604	90,552	243,416	443,742
Aktivët totale	285,933	93,147	88,768	120,142	247,421	835,411
Detyrimet kontraktuale						
Detyrimët 1						
Detyrimet ndaj bankave (detyrimet ditore)	282	-	-	-	-	282
Detyrimet ndaj klienteve (detyrimet ditore)	518,848	-	-	-	-	518,848
Detyrimet kontingjente nga garancitë	26,608	-	-	-	-	26,608
Zotimet e papërdorura të kredisë	47,030	-	-	-	-	47,030
Detyrimët 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	21,046	21,258	24,844	60,684	33,230	161,062
Huamarrje dhe detyrime të varura	-	-	-	-	14,545	14,545
Detyrimet totale kontraktuale	613,814	21,258	24,844	60,684	47,775	768,375
Hendek periodik kontraktual i likuiditetit	(327,881)	71,889	63,924	59,458	199,646	67,036
Hendek kumulativ kontraktual i likuiditetit	(327,881)	(255,992)	(192,068)	(132,610)	67,036	
Detyrimet e pritura						
Detyrimët 1						
Detyrimet ndaj bankave (detyrimet ditore)	141	141	-	-	-	282
Detyrimet ndaj klienteve (detyrimet ditore)	103,770	20,754	31,131	62,261	300,932	518,848
Detyrimet kontingjente nga garancitë	1,294	-	-	-	-	1,294
Zotimet e papërdorura të kredisë	9,390	-	-	-	-	9,390
Detyrimët 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	21,046	21,258	24,844	60,684	33,230	161,062
Huamarrje dhe detyrime të varura	-	-	-	-	14,545	14,545
Detyrimet totale te pritura	135,641	42,153	55,975	122,945	348,707	705,421
Hendeku periodik i likuiditetit	150,292	50,994	32,793	(2,803)	(101,286)	129,990
Hendeku kumulativ i likuiditetit	150,292	201,286	234,079	231,276	129,990	

Për qëllime likuiditeti, Banka klasifikon depozitat me kërkesë dhe depozitat e kursimit si obligim me kërkesë, duke i raportuar në periudhën kohore të maturitetit deri në 1 muaj. Kjo çon në hendeqe të larta kontraktuale të likuiditetit për periudhat kohore deri në 12 muaj. Sidoqoftë, mundësia që shuma shumë të mëdha të depozitave të klientëve do të tërhiqen është shumë e vogël. Prandaj, Banka nuk e konsideron si afatshkurtër hendekun e likuiditetit, duke u fokusuar në hendekun e pritur të maturitetit, që paraqet një skenar më të mundshëm.

Banka ruan një portofol të Aktiveve shumë të tregtueshme financiare (aktiveve financiare VPS) që lehtës mund të likuidohen si mbrojtje kundër ndërprerjeve të paparashikuara në rrjedhën e parasë së gatshme.

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Menaxhimi i Bankës monitoron normat e likuiditetit kundrejt kërkesave të brendshme dhe rregullative në baza ditore, javore dhe mujore. Si rezultat, menaxhmenti beson që Banka nuk ka hendek afatshkurtër të likuiditetit. Gjatë vitit 2015, Banka ka aplikuar teste stresi të likuiditetit në baza mujore për të gjitha valutat operative dhe ka diskutuar për këtë në mënyrë të rregullt në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut dhe ALCO. Testi i stresit kryhet për tre skenarë të ndryshëm sipas Politikës së Menaxhimit të Rrezikut të Likuiditetit, nga ato më pak konservative deri te skenarët më konservativë. Nëse bordi menaxhues dhe departamenti i menaxhimit të rrezikut sheh ndonjë vështirësi në performim nën këta skenarë, ata ndërmarrin hapat e nevojshëm për të minimizuar ndonjë rrezik.

(d) Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Bankës për menaxhim të kapitalit janë: (i) të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit të caktuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK); (ii) të mbrojë aftësinë e Bankës për të vazhduar ne vijimësi, që ajo të vazhdojë të ofrojë kthime për aksionarët dhe benefite për aksionarët e tjerë, dhe (iii) të ruajë një bazë të fuqishme të kapitalit për të mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Adekuatshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator janë monitoruar në baza mujore nga menaxhmenti i Bankës, duke angazhuar teknika bazuar në udhëzimet e BQK. Informatat e kërkuara janë ofruar tek BQK në baza tremujore.

Aktivet me peshë rreziku (APR) janë matur përmes një hierarkie prej pesë nivelesh të rrezikut, klasifi-

kuar sipas natyrës së tyre dhe duke reflektuar një llogaritje të kredisë, tregut dhe rreziqeve të tjera të lidhura me secilin aset dhe për ekspozimet jashtë bilancit, me disa përshtatje për të reflektuar natyrën kontingjente të humbjeve potenciale.

BQK kërkon nga Banka që të mbajë një nivel minimal të kapitalit rregullator prej 7,000 mijë EUR, për të mbajtur një normë të kapitalit me aktivet me peshë të rrezikut Niveli I ('Norma Bazel') në ose mbi minimumin e 8%, dhe për të ruajtur një kapital total rregullator (Niveli II) të normes së aktiveve të ponderuara me peshë rreziku në ose mbi një minimum prej 12%.

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 normat e adekuatshmërisë së kapitalit të Bankës në pajtim me rregulloret e BQK-se janë:

	2015	2014
Kapitali Niveli I		
Kapitali aksionar dhe primi i lidhur me aksionin	65,550	65,550
Rezervat	511	511
Fitimet e mbajtura	32,225	26,215
Minus: Aktivet e patrupëzuara	(581)	(808)
Minus: Kreditë për personat e lidhur me Bankën	(5,812)	(7,850)
Minus: Aktivet për tatimet e shtyra	(116)	(8)
Kapitali total i pranuar Niveli I	91,777	83,610
Kapitali Niveli II		
Detyrimi i varur	7,500	13,136
Provizionet për humbjet e kredive (të kufizuara në 1.25% të APR)	6,216	6,069
Kapitali total i pranuar Niveli II	13,716	19,205
Kapitali total rregullator	105,493	102,815
Aktivet me peshë rreziku:		
Në bilancin e gjendjes	470,436	464,374
Jashtë bilancit të gjendjes	26,865	21,122
Aktivet për rrezik operativ	59,964	64,427
Aktivet totale me peshë rreziku	557,265	549,923
Norma e adekuatshmerise së kapitalit Niveli I	16.47%	15.20%
Norma e adekuatshmerise së kapitalit Niveli II	18.93%	18.70%

(e) Kapaciteti për bartjen e rrezikut

Përveç normave rregullatore të kapitalit, Banka vlerëson mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur konceptin e kapacitetit të bartjes së rrezikut për të reflektuar profilin specifik të rrezikut të Bankës, d.m.th. krahasimin e humbjeve potenciale nga operacionet e saj me kapacitetin e Bankës për të bartur humbjet e tilla.

Për kalkulimin e humbjeve potenciale në kategoritë e ndryshme të rrezikut, janë përdorur konceptet në vijim:

- Rreziku kreditor (klientët): Norma e humbjeve historike dhe shpërndarja e tyre statistikore janë kalkuluar bazuar në analizën e përditësuar rregullisht të portofolit të kredive. Normat e humbjeve historike në kategoritë e vonesave të ndryshme (në nivel besimi 95%) aplikohen për portofolin e kredive për të kalkuluar humbjet potenciale nga kreditë.

- Rreziku homolog (i palës tjetër): Llogaritja e humbjeve potenciale për shkak të rrezikut homolog është bazuar në probabilitetin e mospagesave që paraqiten nga kategorizimi ndërkombëtar përkatës i palës homologe ose shtetit të saj përkatës të operimit (pas rregullimit).

- Rreziku i tregut: Derisa lëvizjet historike të valutës analizohen në mënyrë statistikore dhe variancat më të larta (nivel besimi 99%) aplikohen për pozitat e tanishme të valutës, rreziku i normës së interesit kalkulohe duke përcaktuar ndikimin e vlerës ekonomike të tronditjes së normës standarde të interesit për EUR/USD (2 përqind pikë, tronditja e normës së interesit të Bazeli) dhe niveleve më të larta të tronditjes për valutat e tjera.

- Rreziku operativ: Qasja e standardit Bazeli II përdoret për të kalkuluar vlerën përkatëse.

Banka ka treguar një nivel modest të përdorimit të BDMRr (Burimet ne Dispozicion per Mbulimin e Rrezikut) të saj deri më 31 dhjetor 2015. Përdorimi i limitit të rrezikut homolog dhe të tregut ishin sërish të ulët, duke reflektuar qasjen kundërshtuese të menaxhmentit ndaj rrezikut, që udhëheq operacionet e thesarit të Bankës.

Kapitali ekonomik i kërkuar për mbulimin e rrezikut operativ është kalkuluar sipas qasjes standarde Bazeli II. Të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2015 në Bazën e të dhënave të Ngjarjeve të Rrezikut (RED), e cila regjistron të dhënat e ngjarjeve të rrezikut në shkallë të Bankës dhe në shkallë grupi, tregon

nivel të ulët të rrezikut operativ. Të gjitha rreziqet e kombinuara, të kuantifikuara përmes metodave të përcaktuara në politikat e Bankës, ishin konsiderueshëm nën limitin prej 60% të kapacitetit total të bartjes së rrezikut.

6. Vlera e drejtë e instrumentave financiarë

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të tregtuara ne tregje aktive bazohet në çmime të kuotuar të tregut ose ne kuotime të tregtarëve. Banka vendos vlerat e drejta për instrumentat financiarë duke përdorur metodologjitë e duhura të vlerësimit.

Vlera e drejtë e instrumentave financiare të tregtuara jo shpesh ka më pak transparencë çmimi, pra vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon gjykim në nivele të ndryshme që varen nga likuiditeti, përqendrimi, pasiguritë e faktorëve në treg, supozimet e çmimit, dhe risqe të tjerë që ndikojnë në një instrument financiar specifik.

(a) Modelet e vlerësimit

Banka mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

Niveli 1: inputet janë çmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për instrumente identike. Niveli 2: inputeve të tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1, që janë të observueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë (si çmimet) ose të tërthortë (p.sh. rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumenta identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak aktive; ose teknika vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Niveli 3: inputet janë jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet për të cilat metoda e vlerësimit përfshin inpute që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme për

të cilat kerkohen rregullime të rëndësishme, jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve të parave, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të vëzhgueshme, dhe metoda të tjera. Supozimet dhe inputet e përdorura në metodat e vlerësimit përfshijnë normat e interesit pa rrezik në treg, normat e kredisë dhe prime të tjera të përdorura në llogaritjen e normave të skontuara, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit në monedhë të huaj, çmimet e kapitalit dhe indeksit të kapitalit, dhe luhatjet e pritshme e çmimeve dhe korrelacionet.

Objekti i teknikave të vlerësimit është të arrijë në matjen e vlerës së drejtë e cila reflekton çmimin që do të marrë për të shitur aktivin ose paguar për transferimin e detyrimit në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Banka përdor modele të njohura gjerësisht të vlerësimit për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve më të zakonshme dhe më të thjeshta, të tilla si norma e interesit dhe këmbime të monedhës që përdorin vetëm të dhëna të publikuara tregu dhe që kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim. Çmimet e vëzhgueshme ose inputet model janë zakonisht në dispozicion në treg për borxhin e listuar dhe letrat me vlerë të kapitalit. Disponibiliteti i çmimeve të publikuara në bursë të vëzhgueshme redukton nevojën për gjykim dhe vlerësim, dhe redukton pasigurinë e shoqëruar me përcaktimin e vlerave të drejta. Disponueshmëria e çmimeve të vëzh-

gueshme në bursë dhe faktorëve ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur që të ndryshojë në bazë të ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

Vlerësimet e vlerave reale të përfuara nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë, të tillë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modelit, deri në atë masë që Banka beson se një pjesëmarrës në treg si palë e tretë do t'i marrë ato parasysht në vendosjen e çmimit të një transaksioni. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kreditimit të instrumentave dhe përfshin rregullime për të marrë parasysht rrezikun e kredisë të Bankës dhe dhe palëve të tjera kur është e përshtatshme.

Inputet dhe vlerat e modelit kalibrohen ndaj të dhënave historike dhe parashikimeve të publikuara dhe, kur është e mundur, kundrejt transaksioneve korente ose të fundit të vëzhguara për instrumente të ndryshme dhe kundrejt kuotimeve të tregtarëve.

Ky proces kalibrimi është prej natyre subjektiv dhe jep një segment inputesh të mundshme dhe vlerësimesh të vlerës së drejtë, dhe gjykimi i menaxhimit është i nevojshëm për të zgjedhur pikën më të përshtatshme në segment.

(b) Instrumenta financiarë të mature me vlerë të drejtë – hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme analizon instrumentet financiare të matur me vlerën e drejtë në datën e raportimit, sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilin matja me vlerën e drejtë është kategorizuar. Këto vlera janë njohur në pasqyrën e pozicionit financiar.

Aktivët financiarë të vlefshme për shitje (borxh)	Totali i vlerës së drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
31 dhjetor 2015	87,954	63,654	24,300	-
31 dhjetor 2014	94,971	81,613	13,358	-

(c) Instrumenta financiarë jo të matur me vlerën e drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën

e drejtë dhe analizon ato sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilën çdo matje me vlerën e drejtë është kategorizuar.

	Vlera e mbartur 2015	Vlera e drejtë Niveli 2 2015	Fair value Level 3 2015	Vlera e mbartur 2014	Vlera e drejtë Niveli 2 2014	Vlera e drejtë Niveli 3 2014
Aktivt financiare						
Para dhe saldo me Bankën Qendrore	164,808	164,808	-	162,051	162,051	-
Kredi dhe avanca për bankat	81,861	81,861	-	110,434	110,434	-
Kredi dhe avanca për klientë	436,730	-	424,263	415,512	-	406,971
Aktive të tjera financiare	1,941	1,941	-	2,716	2,716	-
Detyrime financiare						
Detyrime ndaj bankave	249	249	-	282	282	-
Detyrime ndaj klientëve	678,057	576,648	101,027	686,211	523,878	161,787
Huamarrje dhe detyrime të varura	15,668	-	15,360	14,825	-	14,825
Detyrime të tjera financiare	1,267	1,267	-	1,107	1,107	-

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe paradhëniet është e bazuar në transaksionet e tregu të vëzhgueshme. Kur transaksione tregu të vëzhgueshme nuk janë në dispozicion, vlera e drejtë është logaritur duke përdorur metoda të vlerësimit, të tilla si teknikat e skontimit të rrjedhës së parasë. Inputet në teknikat e vlerësimit përfshijnë humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetës, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për kreditë e zhvlerësuar që varen prej kolateraleve, vlera e drejtë matet bazuar në vlerën e kolateralit përkates. Për të përmirësuar

saktësinë e vlerësimit të kredive individuale dhe të vogla tregtare, kreditë homogjene janë të grupuara në portofole me karakteristika të ngjashme.

Vlera e drejtë e depozitave nga bankat dhe klientët llogaritet duke përdorur teknikën e skontimit të rrjedhës së parasë, duke aplikuar normat që janë të ofruara për depozitat me maturitete dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme kur kërkohen, është shuma për t'u paguar në datën e raportimit.

7. Të ardhurat neto nga interesi

	2015	2014
Të ardhurat nga interesi		
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	45,603	54,684
Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave	387	185
Aktivt financiare të vlefshme për shitje	7	199
Të tjera	86	270
Totali i të ardhurave nga interesi	46,083	55,338
Shpenzime interesi		
Detyrime ndaj klientëve	1,998	7,079
Fondet e huazuara	973	1,889
Të tjera	153	155
Totali i shpenzimeve të interesit	3,124	9,123
Të ardhurat neto nga interesi	42,959	46,215

Të ardhurat nga interesi i kredive dhe avancat e klientëve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 arrijnë totalin prej 843 mijë EUR (2014: 1,205 mijë EUR)

për aktive financiare të zhvlerësuar dhe efektin e skontimit për zhvlerësimin e huave në shumën 1,628 mijë EUR (2014: 2,681 mijë EUR).

8. Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

	2015	2014
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		
Transferet dhe transaksionet e pagesave	4,594	4,121
Letrat e kredisë dhe garancitë	1,179	738
Tarifat e mirëmbajtjes së llogarisë	1,260	1,387
Kartat e debitit dhe të kreditit	2,665	2,867
Të ardhurat nga tarifat e tjera dhe komisionet	797	1,019
Totali i të ardhurave nga tarifat dhe komisionet	10,495	10,132
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet		
Ofruesi i TI-së dhe shërbimet përkatëse	1,242	1,166
Tarifat dhe komisionet ndaj llogarive bankare	525	627
Tarifat e tjera ndaj bankave	507	268
Tarifat dhe shpenzimet e lidhura me kartat	444	492
Tarifat dhe komisionet e tjera	1,307	1,216
Totali i shpenzimeve nga tarifat dhe komisionet	4,025	3,769
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	6,470	6,363

9. Shpenzimet administrative dhe të tjera operative

	2015	2014
Shpenzime personeli (shih më poshtë)	9,728	10,085
Zhvlerësim dhe amortizim (shih shënimin 15 dhe 16)	2,943	3,331
Shpenzime qiraje	2,080	2,294
Mirëmbajtje dhe riparime	1,519	1,686
Shpenzime reklame dhe promocionale	866	893
Tarifa ligjore dhe konsulence	1,118	862
Shërbime sigurie	626	669
Shpenzime të paguara ProCredit Holding	778	808
Shërbime komunale	757	567
Shpenzime trajnimi	759	718
Shpenzime për fondin e sigurimit të depozitave	752	737
Komunikim (telefon, lidhje rrjeti)	605	549
Transport (karburant, mirëmbajtje)	319	313
Furnizime zyre	229	304
Të drejta përdorimi për softuerët	379	367
Provizione për garancitë e dhëna	200	252
Heqja nga përdorimi i tokës dhe pajisjeve	1,513	96
Shpenzime të tjera	2,434	1,965
	27,605	26,496

Më 31 dhjetor 2015 Banka punësonte 544 punonjës (2014: 689 punonjës).

	2015	2014
Rrogat dhe pagat	8,000	9,002
Kontributi pensional	397	447
Benefitet dytësore	160	314
Kompensime të tjera	1,171	322
	9,728	10,085

10. Shpenzimet e tatim fitimit

(a) Shumat e njohura në fitim ose humbje

	2015	2014
Tatimi në fitimin e vitit	2,956	2,829
Të ardhurat nga tatimi i shtyrë	(743)	(713)
Shpenzimet e tatim fitimit	2,213	2,116

Tatimi mbi fitimin llogaritet bazuar në rregulloret e tatimit mbi fitimin të zbatueshme në Kosovë, duke përdorur normat në fuqi të tatimit në datën rapor-

tuese. Norma e tatimit për të ardhurat e korporatës është 10% (2014: 10%).

(b) Shumat e njohura në të Ardhurat e Tjera Përmbledhëse ('ATP')

	2015			2014		
	Para tatimit	Përfitimi tatimor	Neto nga Tatimi	Para tatimit	Përfitimi tatimor	Neto nga Tatimi
Investimet e vlefshme për shitje	64	(6)	58	227	(22)	205
Totali						
(shih Shënimin 24)	64	(6)	58	227	(22)	205

(c) Barazimi i normës efektive tatimore

Më poshtë paraqitet barazimi i tatimeve përlogari-

tur me normën e zbatueshme prej 10% (2014: 10%) me shpenzimin aktual tatimor:

	Norma	2015	Norma	2014
Fitimi para tatimit		20,583		16,669
Tatimi me normën tatimore të korporatave	10.0%	2,058	10.0%	1,667
Të ardhurat e patatueshme	-0.3%	(68)	0.0%	-
Shpenzimet e pazbritshme tatimore	0.8%	166	0.1%	21
Shpenzime shtesë nga provizionet e ndryshme për kreditë dhe interesin aktual nga kreditë bazuar në rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës	3.9%	800	6.8%	1,141
Efektet nga tatimi i shtyrë	-3.6%	(743)	-4.3%	(713)
	10.8%	2,213	12.7%	2,116

Tatim fitimi i parapaguar më 31 dhjetor 2015 është 330 mijë Euro (31 dhjetor 2014: tatim fitimi i pagueshëm 371 mijë Euro).

(d) Lëvizjet në gjendjet e tatimit të shtyrë

Tatimi i shtyrë është llogaritur bazuar në normën e miratuar prej 10% (2014: 10%).

	2015	Lëvizjet në fitim ose humbje	Levizjet në ATP	2014
Tatim i shtyrë aktiv				
Investimet e vlefshme për shitje	2	-	(6)	8
Interesi aktual nga depozitat	98	(77)	-	175
Zhvlerësimi për pasuri dhe pajisje	17	20	-	(3)
Provizione për zhvlerësimin e kredive	496	759	-	(263)
	613	702	(6)	(83)
Detyrim tatimi i shtyrë				
Interesi aktual nga kreditë	(69)	41	-	(110)
	(69)	41	-	(110)
Aktivi/(detyrimi) i tatimit të shtyrë neto	544	743	(6)	(193)

11. Paraja e gatshme dhe saldot me Bankat Qendrore

	2015	2014
Paraja e gatshme	84,936	47,950
Letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës (deri në 3 muaj)	250	300
Shumat e mbajtura në BQK		
Llogaritë rrjedhëse	52,546	69,045
Rezerva e detyrueshme	24,678	42,767
Saldo me Deutsche Bundesbank	2,398	1,989
	164,808	162,051

Në pajtim me kërkesat e BQK lidhur me depozitën minimale rezervë që duhet mbajtur për qëllime likuiditeti Banka mban minimumin e kërkuar prej 10% të depozitave të klientëve të saj me maturitet deri në një vit si rezervë të detyrueshme. Rezerva e detyrueshme përfaqëson instrumente me likuiditet të lartë që përfshijnë paratë e gatshme, llogaritë

me BQK ose banka të tjera në Kosovë, dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jenë më pak se gjysma e totalit të rezervës së detyrueshme.

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si vijon: 209,715

	2015	2014
Paraja e gatshme dhe saldot me Bankat Qendrore	164,808	162,051
Rezerva e detyrueshme	(24,678)	(42,767)
Kredi dhe paradhënie me bankat me maturitet 3 muaj ose me pak (shënimi 12)	81,852	90,431
	221,982	209,715

12. Kredi dhe paradhënie për bankat

	2015	2014
Llogaritë rrjedhëse	26,113	47,237
Depozitat me afat në banka	55,748	63,197
	81,861	110,434

Normat e interesit vjetor mbi depozitat me afat në banka në fund të periudhës raportuese ishin si në vijim:

- Depozitat në EUR: nga (0.15)% deri 0.07 % p.a. (2014: nga 0.25% to 0.02% p.a.); dhe
- Depozitat në USD: nga 0.42% deri 0.40% p.a. (2014: nga 0.31% to 0.10% p.a.).

13. Kredi dhe paradhënie për klientët

	2015	2014
Kreditë për klientët	411,725	401,958
Mbitërheqjet	47,636	40,831
Kartat e kreditit	793	953
Tarifat e shtyra të disbursimit	(978)	(1,311)
Interesi aktual mbi kreditë	3,394	4,395
	462,570	446,826
Fondi i zhvlerësimit për humbjet nga kreditë	(25,840)	(31,314)
	436,730	415,512

	2015			2014		
	Shuma Bruto	Fondi i zhvlerë.	Shuma Neto	Shuma Bruto	Fondi i zhvlerë.	Shuma Neto
<i>Klientët individualë:</i>						
Mbitërheqjet	3,030	(690)	2,340	3,442	(193)	3,249
Kartat e kreditit	796	(90)	706	956	(125)	831
Kreditë konsumatore	7,823	(247)	7,576	6,174	(173)	6,001
Përmirësimi i shtëpive	118,321	(4,724)	113,597	123,519	(3,389)	120,130
<i>Klientët korporata:</i>						
Mbitërheqjet	44,696	(1,407)	43,289	37,685	(1,776)	35,909
Deri në 150 mijë Euro	166,633	(12,982)	153,651	168,404	(14,954)	153,450
Mbi 150 mijë Euro	121,271	(5,700)	115,571	106,646	(10,704)	95,942
	462,570	(25,840)	436,730	446,826	(31,314)	415,512

Lëvizjet në fondin e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë më 31 dhjetor 2015 ishin si në vijim:

	2015	2014
Më 1 janar	31,314	34,164
Ngarkesa për vitin	3,143	11,478
Efekti kohor i skontimit	(1,627)	(2,681)
Kreditë e fshira	(6,990)	(11,647)
Më 31 Dhjetor	25,840	31,314

Më 31 dhjetor 2015, portofoli i kredive përfshinte kreditë për punonjësit e Bankës në shumën prej 1,830 mijë EUR (2014: 2,924 mijë EUR). Këto kredi janë monitoruar nga Banka Qendrore e Kosovës

(BQK), që përcakton limite maksimale të lejuara për kredi të tilla në raport me kapitalin rregullator të Bankës

14. Aktive financiare të vlefshme për shitje

	2015	2014
Aksionet në kompanitë e vendosura në shtetet e OECD	58	24
Letrat me vlerë të borxhit	86,918	94,184
Interesi akrual	1,036	787
Totali	88,012	94,995

15. Aktivet e patrupëzuara

	Softueri
<i>Kosto</i>	
Më 1 janar 2014	5,208
Shtesat	441
Më 31 dhjetor 2014	5,649
Shtesat	636
Largimet nga përdorimi	(4)
Më 31 dhjetor 2015	6,281
<i>Amortizimi i akumuluar</i>	
Më 1 janar 2014	4,038
Shpenzimi për vitin	763
Më 31 dhjetor 2014	4,801
Shpenzimi për vitin	863
Largimet nga përdorimi	(4)
Më 31 dhjetor 2015	5,660
<i>Vlera neto e mbartur</i>	
Më 31 dhjetor 2014	848
Më 31 dhjetor 2015	621

16. Pronat dhe pajisjet

	Toka	Ndërtesat	Aktivitet në ndërtim	Mobiljet dhe orenditë	Pajisjet elektronike	Përmirësimet e objekteve me qira	Totali
Kosto							
Më 1 janar 2014	4,907	6,634	1,019	1,574	17,984	4,176	36,294
Shtesat	-	68	307	20	890	257	1,542
Largimet nga përdorimi	-	-	(1,247)	(50)	(1,287)	(220)	(2,804)
Më 31 dhjetor 2014	4,907	6,702	79	1,544	17,587	4,213	35,032
Shtesat	-	71	1,473	110	5,434	749	7,837
Largimet nga përdorimi	-	(544)	(820)	(153)	(2,699)	(2,974)	(7,190)
Më 31 dhjetor 2015	4,907	6,229	732	1,501	20,322	1,988	35,679
Amortizim i akumuluar							
Më 1 janar 2014	-	1,907	-	1,347	13,410	2,662	19,326
Shpenzimi për vitin	-	349	-	123	1,865	231	2,568
Largimet nga përdorimi	-	-	-	(50)	(1,084)	(137)	(1,271)
Më 31 dhjetor 2014	-	2,256	-	1,420	14,191	2,756	20,623
Shpenzimi për vitin	-	340	-	77	1,446	217	2,080
Largimet nga përdorimi	-	(237)	-	(112)	(592)	(2,139)	(3,080)
Më 31 dhjetor 2015	-	2,359	-	1,385	15,045	834	19,623
Vlera neto e mbartur							
Më 31 dhjetor 2014	4,907	4,446	79	124	3,396	1,457	14,408
Më 31 dhjetor 2015	4,907	3,870	732	116	5,277	1,154	16,056

17. Aktive të tjera financiare

	2015	2014
Tarifa akruale të mirëmbajtjes së llogarisë	329	346
Depozitat e sigurisë	574	515
Të arkëtueshme nga institucionet financiare	870	937
Aktive të mbajtura për shitje	-	911
Aktivet e tjera financiare	168	7
	1,941	2,716

Aktivet e tjera financiare nuk janë as obligim i vonuar në standarde sipas kategorizimit kreditor të Bankës e as të zhvlerësuar dhe janë klasifikuar në kategori-

18. Aktive të tjera

	2015	2014
Shpenzimet e parapaguara	180	297
Aktivet e tjera	710	492
	890	789

19 Detyrime ndaj bankave

	2015	2014
Llogaritë rrjedhëse	249	282
	249	282

20. Detyrime ndaj klientëve

	2015	2014
Llogaritë rrjedhëse	365,698	315,278
Llogaritë e kursimit	208,858	208,992
Depozitat me afat	97,499	154,181
Llogaritë e tjera të klientëve	2,183	1,479
Interesi aktual	3,819	6,281
	678,057	686,211

Detyrime ndaj klientëve (llogaritë rrjedhëse, të kursimit dhe me afat) përfshijnë shumën prej 5,925 mijë EUR (2014: 6,526 mijë EUR) që përfaqësojnë depozita të bllokuara, të ofruara si kolateral për kreditë, garancitë,

letrat e kreditit dhe urdhër pagesat në emër të klientëve. Normat vjetore të interesit të shpallura më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	2015	2014
Depozitat e kursimit	0.05%	0.25%
Depozitat me afat:		
Gjashtë muaj	n/a	0.05%
Një vit	0.05%	0.10%
Dy vjet	0.10%	0.20%
Tre vjet	0.50%	0.70%
Katër vjet	1.00%	1.00%
Pesë vjet	1.50%	1.50%

Llogaritë rrjedhëse zakonisht nuk mbartin interesa.

21. Hua dhe detyrime të varura

	2015	2014
Detyrimet e varura ProCredit Holding AG & CO.KGaA	7,647	7,667
Huamarrjet nga Fondi Evropian për Evropën Juglindore ("EFSE")	-	7,158
Huamarrjet nga Banka Evropiane e Investimeve (EIB)	8,021	-
	15,668	14,825

Detyrimet e varura në shumë prej 7,500 mijë EUR (2014: 7,500 mijë EUR) u pranuan prej ProCredit Holding AG & CO.KGaA, nën marrëvshjen e huasë nënshkruar në shtator 2014. Huazimi i varur më 31 dhjetor 2015, në shumë prej 7,647 mijë EUR përfshin principalin dhe interesin aktual.

Në bazë të miratimit të dhënë nga Banka Qendrore e Kosovës, detyrimet e varura janë klasifikuar si kapital i nivelit të dytë dhe përfshihen në kapitalin rreg-

ullator të Bankës.

Huamarrjet nga EFSE më 31 dhjetor 2014, në shumën prej 7,158 mijë EUR janë ripaguar tërësisht në vitin 2015.

Bazuar në një kontratë me EIB të nënshkruar në nëntor 2013, Banka gjatë vitit 2015 ka pranuar një shumë prej 8,000 mijë EUR (2014: zero) me qëllim të financimit të projekteve të cilat janë ndërmarrë nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

22. Detyrime të tjera financiare

	2015	2014
Shpenzimet akruale	133	153
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	880	660
Detyrime ndaj palëve të lidhura	159	191
Të pagueshme ndaj Fondit të Pensioneve të Kosovës	95	103
	1,267	1,107

23. Detyrime të tjera

	2015	2014
Provizioni për pushimin e pashfrytëzuar	207	222
Provizioni për rastet gjyqësore	706	345
Provizioni për garancitë	278	323
Të tjera	925	1,866
	2,116	2,756

24. Kapitali aksionar dhe rezervat

Kapitali aksionar

Më 31 dhjetor 2015, kapitali aksionar i autorizuar

përbëhej nga 12,269,242 aksione të zakonshme (2014: 12,269,242), me vlerë nominale 5 EUR secili, ndërkohë që struktura e zotërimit të kapitalit është si vijon:

	Numri i aksioneve	2015		Numri i aksioneve	2014	
		Në EUR	%		Në EUR	%
ProCredit Holding	12,269,242	61,346,210	100	12,269,242	61,346,210	100
	12,269,242	61,346,210	100	12,269,242	61,346,210	100

Aksionet e emetuara janë plotësisht të paguara. Nuk ka kufizime, kushte ose preferime të bashkëngjitura aksioneve të zakonshme.

Premia e aksioneve

Premia e aksioneve paraqet vlerën e kontributeve të pranuar në tejkallim të vlerës emërore të aksioneve të emetuara. Vlera e premisë së aksionit në fund të vitit 2015 ishte në shumën prej 4,204 mijë EUR (2014: 4,204 mijë EUR).

Rezerva e kontigjencës

Në vitin 2000, është krijuar një rezervë kontigjence

prej 511 mijë EUR (1 milionë marka gjermane) nga një kapitalizim i fitimeve të mbajtura. Rezerva paraqet një provizion kundrejt rrezikut politik dhe nuk mund të shpërndahet në dividendë pa miratimin paraprak të BQK.

Rezerva e vlerës së drejtë

Rezerva e vlerës së drejtë përfshin ndryshimin kumulativ neto në vlerën e drejtë të investimeve të vlefshme për shitje, deri në momentin kur investimi çregjistrohet ose zhvlerësohet. Lëvizjet në rezervën e vlerës së drejtë paraqiten më poshtë:

	2015	2014
Saldo më 1 janar	(64)	(269)
Rënie të vlerës së rezervës për investimet VPS	2,057	(417)
Rritje të vlerës së rezervës për investimet VPS	(1,993)	644
Tatimet e shtyra në rezervën e vlerës së drejtë	(6)	(22)
Saldo më 31 Dhjetor	(6)	(64)

Dividendë të paguar

Shpërndarja e dividendëve në shumën prej 20 mil-

ionë EUR (2014: 20 milionë EUR) u miratua në maj dhe u pagua në qershor 2015

25. Transaksione me palë të lidhura

Procredit Grupi ("Grupi") është i përbërë nga banka të orientuara drejt zhvillimit të cilat operojnë në Evropën Lindore dhe Amerikën Latine, si dhe një bankë në Gjermani. Kompania mëmë e Grupit është Procredit Holding i cili është një entitet me bazë në Frankfurt që drejton Grupin. Në një nivel të konsoliduar, Grupi mbikëqyret nga autoritetet mbikëqyrëse bankare federale të Gjermanisë (BaFin dhe Bundes-Bank). Grupi Procredit ka për qëllim që të arrijë të kombinojë ndikimin e zhvillimit të lartë me suksesin tregtar për aksionarët e tij.

Aksionarët kryesorë të ProCredit Holding AG & Co. KGaA dhe pjesëmarrjet e tyre në kapitalin aksionar paraqiten si më poshtë:

- IPC – Internationale Projekt Consult GmbH: 18.4% (2014: 18.4%);
- KfW Development Bank: 13.6% (2014: 13.6%);
- DOEN Foundation: 13.3% (2014: 13.3%); dhe
- International Finance Corporation (IFC): 10.3% (2014: 10.3%).

25. Transaksionet me palë të lidhura (vazhdim)

Gjatë kryerjes së biznesit bankar, Banka hyn në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura dhe gjendet me aksionarët dhe entitetet e lidhura në 31 dhjetor 2015 dhe 2014, jepen si më poshtë:

Aktive të arkëtueshme nga:		
Kredi dhe avanca me banka të tjera ProCredit	5,664	7,673
Aktive financiare me banka të tjera ProCredit	73	95
Aktive financiare me Quipu GmbH	59	49
Aktive të tjera financiare	48	20
	5,844	7,837
Detyrime ndaj:		
Detyrimet ndaj bankave të tjera ProCredit	194	144
Detyrime financiare ndaj bankave të tjera ProCredit	159	180
Detyrimet ndaj ProCredit Holding AG & Co. KGaA	124	134
Detyrimet ndaj Quipu GmbH	306	246
Huazime të varura nga ProCredit Holding AG & Co. KGaA	7,647	7,667
	8,430	8,371

Më 31 dhjetor 2015, Banka kishte një marrëveshje për linjë kredie me ProCredit Holding me një shumë limit të patërhequr deri në 15,000 mijë EUR (2014: 15,000 mijë EUR), që maturohet më 11 Mars 2016

(data e maturimit duhet të zgjatet automatikisht për një vit), dhënë me qëllim të përmbushjes së nevojave të përgjithshme financiare.

Të ardhura nga interesi nga:	2015	2014
Të ardhura nga interesi nga bankat ProCredit	3	8
Të ardhura të tjera nga Grupi ProCredit	3	3
	6	11
Shpenzimet:		
Mëma: Shpenzimet e interesit nga detyrimet e varura	538	167
Mëma: Shpenzimet e tjera administrative	1,007	810
Mëma dhe Akademitë: Shpenzimet e trajnimit	541	418
Mëma: Shpenzimet e tarifës së zotimit	152	152
Quipu GmbH: Shpenzime të TI-së	955	661
Quipu GmbH: Shpenzimet e tarifave të kartave	1,250	1,072
	4,443	3,280
	2015	2014
Kompensimet e manaxhmentit të lartë:		
Pagat	246	236
Kontributet pensionale	12	10
Tatimet në të ardhurat personale	22	21
	280	267

26. Zotimet dhe kontingjencat

	2015	2014
Zotimet për ofrimin e kredive, letrat e kredive dhe garancitë		
Zotimet e lidhura me kreditë (shiko detaje më poshtë)	55,946	47,030
Garancitë ndërkombëtare	15,282	11,497
Garancitë lokale	12,812	14,812
Letrat e kredisë	1,551	299
Minus: Provizionet e njohura si detyrime	(278)	(323)
	85,313	73,315
Zotimet e kredive		
Lehtësirat e papërdorura të kartave të kreditit	4,190	4,248
Limitet e pashfrytëzuara të mbitërheqjes	43,715	35,224
Transhet e padisurbursuara të kredive	2,613	3,682
Pjesa e pashfrytëzuar e linjave kreditore	5,428	3,876
	55,946	47,030

Letrat e garancive dhe kredive të dhëna në favor të klientëve sigurohen nga kolaterale mjetesh monetare, pasuri të paluajtshme ose kundër-garanci të marra nga institucione të tjera financiare.

Zotimet për ofrimin e kredive paraqesin zotimet kontraktuale për të dhënë kredi dhe linja kredish. Zotimet në përgjithësi kanë data fikse të skadimit, ose kushte të tjera të përfundimit. Meqë zotimet mund të skadojnë pa qenë të tërhequra, shumatat totale nuk paraqesin patjetër kërkesa për para të gatshme.

Procedurat ligjore

Banka është përfshirë në konteste ligjore që lidhen me aktivitetin e zakonshëm të biznesit. Menaxhmenti i Bankës beson se rezultati final i këtyre çështjeve

ligjore të hapura më 31 dhjetor 2015 nuk do të rezultojë në humbje materiale në operacionet e Bankës.

Zotimet e qirave operative

Banka ka kontraktuar qira për prona e ambiente tregtare për zyrat e saj. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, pagesat e ardhshme të qirave operative të paanulueshme për Bankën arrijnë në 244 mijë EUR (2013: 175 mijë EUR). Shumica e këtyre angazhimeve nuk zgjasin më shumë se një muaj.

27. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Nuk kanë ndodhur ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin shënime sqaruese në pasqyrat financiare.

